

Kapitulli I. Gjeografia Fizike

Pyetja 1

Në çfarë përqindje masat kontinentale të ngritura janë antipode me depresionet tokësore të zëna nga uji oqeanik:

- A) 75%
- B) 85%
- C) 95%
- D) 65%

Pyetja 2

Sa është raporti i sipërfaqes së oqeaneve me atë të kontinenteve:

- A) 2.43 me 1
- B) 2.33 me 1
- C) 2.53 me 1
- D) 2.63 me 1

Pyetja 3

Në cilën gjerësi gjeografike karakteri kontinental(kontinentaliteti) i hemisferës veriore shpjgohet me supozimin e dominimit të lëvizjeve ngritëse:

- A) gjerësitë gjeografike 70 gradë.
- B) gjerësitë gjeografike 60 gradë.
- C) gjerësitë gjeografike 50 gradë.
- D) gjerësitë gjeografike 80 gradë.

Pyetja 4

Në cilat gjerësi gjeografike karakteri oqeanik(oqeaniteti) i hemisferës jugore shpjgohet me supozimin e dominimit të lëvizjeve ulëse:

- A) gjerësitë gjeografike 70 gradë.
- B) gjerësitë gjeografike 60 gradë.
- C) gjerësitë gjeografike 50 gradë.
- D) gjerësitë gjeografike 80 gradë.

Pyetja 5

Të gjithë kontinentet kanë formën e trekëndëshit të kthyer nga:

- A) Jugu
- B) Veriu
- C) Perëndimi
- D) Lindja

Pyetja 6

Sa përqind të sipërfaqes së kontinenteve zenë lartësitë deri 1000 m mbi nivelin e detit?

- A) 50%

- B) 60%
- C) 70%
- D) 80%

Pyetja 7

Cili kat batimetrik zë sipërfaqen më të madhe të tabanit të oqeaneve dhe deteve?

- A) 1000-3000 m
- B) 2000-5000 m
- C) 3000- 6000 m
- D) 4000-7000 m

Pyetja 10

Sa është thellësia mesatare dhe volumi i ujit i oqeanit botëror?

- A) 4500 m dhe 2 miliard km³
- B) 3500 m dhe 1.37 miliard km³
- C) 5500 m dhe 1.71 miliard km³
- D) 2500 m dhe 1.61 miliard km³

Pyetja 11

Cili është oqeani më i thellë i rruzullit tokësor?

- A) Oqeani Paqësor
- B) Oqeani Atlantik
- C) Oqeani Indian
- D) Oqeani i Ngrirë i Veriut

Pyetja 12

Çfarë quhet "Shelf kontinental"?

- A) Rrafshnalta anësore
- B) Platforma kontinentale
- C) Shpati kontinental
- D) Kanionet nënujorë

Pyetja 13

Ç'janë "meridianet kritikë" të rruzullit tokësor që gjenden në kontinente e oqeanë?

- A) Ngritje të mëdha malore në formën e malësive
- B) Depresione të thella e të gjera shumë të për zgjatur
- C) Vargje të mëdhenj malor meridional e submeridionalë
- D) Gropa të thella e me shtrirje mjaft të gjerë

Pyetja 14

Çfarë pozicioni gjeografik kanë përgjithësisht fushat e mëdha kontinentale?

- A) Në pjesën e brendshme të kontinenteve
- B) Në pjesën veriore të kontinenteve
- C) Në pjesën jugore të kontinenteve

D) Në pjesën perëndimore dhe lindore të kontinenteve

Pyetja 15

Sa është sipërfaqja gjithsej e ishujve të rruzullit tokësorë?

- A) 5 milion km²
- B) 10 milion km²
- C) 12 milion km²
- D) 15 milion km²

Pyetja 16

Ishujt koralorë janë formuar nga:

- A) Depozitimet e ngurta të lumenjve të mëdhenj.
- B) Depozitimet e materialeve të vullkaneve nënujorë.
- C) Depozitimi i kolonive të organizmave të ndryshëm detarë.
- D) Depozitimi i kriprave për shkak të avullimit të madh.

Pyetja 17

Sa është temperatura e përshtatshme për formimin e koraleve?

- A) 15 deri 17 gradë
- B) 10 deri 15 gradë
- C) 30 deri 35 gradë
- D) 18 deri 30 gradë

Pyetja 18

Deri në cilën thellësi ujore mund të zhvillohen zakonisht koralet ?

- A) Deri në thellësinë 25-30 m
- B) Deri në thellësinë 150 m
- C) Deri në thellësinë 70-100 m
- D) Deri në thellësinë 55- 65 m

Pyetja 19

Sa është trashësia e kores së tokës në kontinente?

- A) 0-20 km
- B) 81-150 km
- C) 20-80 km
- D) mbi 150 km

Sa është trashësia e kores së tokës në oqeanë?

- A) 1 deri 4km
- B) 11 deri 15km
- C) 16 deri 20km
- D) 5 deri 10 km

Pyetja 21

Trashësia mesatare e kores së tokës është:

- A) 16-40 km
- B) 12 - 30 km
- C) 17 - 25 km
- D) 18 -35 km

Pyetja 22

Korja e tokës përbëhet nga shtresa me përbërje të ndryshme shkëmbore.

Sima, si pjesë e saj, përbëhet nga:

- A) Shkëmbinj sedimentarë karbonatikë
- B) Shkëmbinj sedimentarë terrigjenë
- C) Shkëmbinj bazaltikë
- D) Shkëmbinj granitikë

Pyetja 23

Shkëmbinjtë sedimentarë të kores së tokës zenë:

- A) 60% të sipërfaqes së kontinenteve
- B) 80% të sipërfaqes së kontinenteve
- C) 70% të sipërfaqes së kontinenteve
- D) 90% të sipërfaqes së kontinenteve

Pyetja 24

Manteli është shtresa e dytë që vijon poshtë kores së tokës. Sa është trashësia e mantelit?

- A) 2790 km
- B) 2890 km
- C) 2680 km
- D) 2880 km

Pyetja 26

Sa është gradienti mesatar i temperaturës së tokës në shtresat e kores poshtë shtresave të ndikuara nga energjia diellore?

- A) 350 për 1 km
- B) 200 për 1 km
- C) 450 për 1 km
- D) 150 për 1 km

Pyetja 27

Temperatura e tokës në kufirin e mantelit me bërthamën është:

- A) 1000-12000
- B) 2000-22000
- C) 3000-32000
- D) 4000-42000

Pyetja 28

Sa është temperatura e tokës në pjesën qendrore të bërthamës së saj?

- A) 30000
- B) 40000
- C) 50000
- D) 60000

Pyetja 29

Cila nga vlerat e mëposhtëme shpreh densitetin mesatar të tokës?

- A) $0,001293\text{gr/cm}^3$
- B) $1,027\text{gr/cm}^3$
- C) $5,52\text{gr/cm}^3$
- D) $2,7\text{gr/cm}^3$

Pyetja 30

Sa është densiteti i tokës në qendër të saj?

- A) $17,2\text{gr/cm}^3$
- B) $16,2\text{gr/cm}^3$
- C) $15,2\text{gr/cm}^3$
- D) $14,2\text{gr/cm}^3$

Pyetja 31

Vlera e densitetit të tokës prej $11,5\text{gr/cm}^3$ gjendet në thellësinë:

- A) 2400 m
- B) 3200 m
- C) 5000 m
- D) 5120 m

Pyetja 32

Në cilën thellësi fillon rritja më e shpejtë e densitetit të tokës?

- A) Në thellësinë 1600 m
- B) në thellësinë 2400 m
- C) Në thellësinë 4000 m
- D) Në thellësinë 2900 m

Pyetja 33

Cila nga frazat e mëposhtëme lidhet me trysninë e tokës në drejtimin lart-posht?

- A) Trysnia hidrostatike
- B) Trysnia litostatike
- C) Trysnia atmosferike
- D) Trysnia e shtresës

Pyetja 34

Sa ndryshon gradienti i trysnisë litostatike për cdo 100 m thellësi në tokë?

- A) 23 kg/cm²
- B) 33 kg/cm²
- C) 13 kg/cm²
- D) 17 kg/cm²

Pyetja 35

Sa është trysnia litostatike në qendër të tokës?

- A) 1.5 milion kg/cm²
- B) 4.5 milion kg/cm²
- C) 3.5 milion kg/cm²
- D) 2.5 milion kg/cm²

Pyetja 36

Për të gjetur vlerën e forcës së gravitetit të cdo pike është e nevojshme të dihet:

- A) Lartësia mbi nivelin e detit e pikës
- B) Thellësia nën nivelin e detit e pikës
- C) Gjerësia gjeografike e pikës
- D) Diferenca midis lartësisë dhe thellësisë

Pyetja 37

Sa është vlera e deklinacionit midis boshtit magnetik të tokës dhe boshtit të tokës?

- A) 120
- B) 110
- C) 130
- D) 100

Pyetja 38

Sa vjet i duhen fushës magnetike të tokës që të kryejë një rrotullim të plotë rreth tokës?

- A) 1000 vjet
- B) 1500 vjet
- C) 2500 vjet
- D) 2000 vjet

Pyetja 39

Madhësia e vlerës së forcës së gravitetit shprehet me anën e:

- A) Izohietave
- B) Izotermave
- C) Izodinameve
- D) Izobateve

Pyetja 41

Shpejtësia e përhapjes së valëve zanore në nivelin e detin në kushtet normale të atmosferës është:

- A) 335 m/sek
- B) 435 m/sek
- C) 235 m/sek
- D) 125 m/sek

Pyetja 42

Në cilin grup litologjik bëjnë pjesë shkëmbinjtë gabrorë (gabrot)?

- A) Në grupin e karbonatikëve
- B) Në grupin e magmatikëve intruziv
- C) Në grupin e magmatikëve efuziv
- D) Në grupin e terrigjenëve

Pyetja 43

Nëse strukturat monoklinale me shtresa të alternuara të forta-të buta kanë pjerrësi deri 40-500, çfarë tip forme relievi formohet?

- A) Kuest
- B) Hogbek
- C) Pengesë
- D) Kreshtë monoklinale

Pyetja 44

Nëse strukturat monoklinale me shtresa të alternuara të forta-të buta kanë pjerrësi deri 700, çfarë forme relievi formohet?

- A) Hogbek
- B) Kuest
- C) Pengesë
- D) Kreshtë monoklinale

Pyetja 45

Cilët lloje shkëmbinjesh janë më të qëndrueshëm ndaj tjetërsimit fizik?

- A) Shkëmbinjtë magmatikë intruziv
- B) Shkëmbinjtë magmatikë efuziv
- C) Shkëmbinjtë karbonatikë
- D) Shkëmbinjtë terrigjenë

Pyetja 46

Cilët nga llojet e shkëmbinjve të mëposhtëm tjetërsohen më shumë deri në formimin e argjilave?

- A) Granitet
- B) Dioritet kvarcore
- C) Gabrot
- D) Peridotitet

Pyetja 47

Cilët nga shkëmbinjtë e mëposhtëm janë më shumë rezistent në të gjitha llojet e klimave?

- A) Dolomitet
- B) Sienitet
- C) Gëlqerorët
- D) Argjilorët

Pyetja 48

Kompleksi i formave të relievit strukturor kushtëzohet në radhë të parë nga:

- A) Llojshmëria litologjike
- B) Tipi i deformimeve tektonike
- C) Tipi i klimës
- D) Erozioni diferencial

Pyetja 49

Çfarë tip strukture tektonike krijon stili tektonik në tërheqje?

- A) Mbihipje
- B) Rrudha
- C) Monoklinal
- D) Horst-graben

Pyetja 50

Çfarë tip strukture tektonike krijon stili tektonik në shtypje?

- A) Rrudha dhe mbihipje
- B) Horst
- C) Graben
- D) Strukturë horizontale

Pyetja 51

Përputhja e relievit me strukturën rrudhosësë antiklinale shprehet në:

- A) Formimin e luginave lumore
- B) Formimin e kuesteve
- C) Formimin e vargjeve malorë
- D) Formimin e fushëgropave

Pyetja 52

Në cilin rast relievit në strukturën horstgrabenore është reliev përputhës?

- A) Kur në horste formohen male
- B) Kur në grabene formohen vargje malorë
- C) Kur në horste formohen gropa
- D) Kur në grabene formohen malësi

Pyetja 53

Çfarë kuptojmë me termin tektoogjenezë?

- A) Procesin e formimit të një tip strukture
- B) Procesin e formimit të një tip relievi
- C) Procesin e formimit të strukturës dhe të relievit
- D) Procesin e depozitimit të materialeve të ndryshme

Pyetja 54

Gjatë cilës erë apo periudhë gjeologjike ka ndodhur tektoogjeneza kaledoniane?

- A) Paleozoit të poshtëm
- B) Mesozoit të poshtëm
- C) Kenozoit të poshtëm
- D) Kuaternarit të poshtëm

Pyetja 55

Gjatë cilës erë apo periudhë gjeologjike ka ndodhur tektoogjeneza herciniane?

- A) Mesozoit të sipërm
- B) Pleozoit të sipërm
- C) Kenozoit të sipërm
- D) Neogjenit të sipërm

Pyetja 56

Gjatë cilës erë apo periudhë gjeologjike ka ndodhur tektoogjeneza alpine e re?

- A) Mesozoit
- B) Permiane
- C) Paleogjenit
- D) Neogjenit

Pyetja 57

Cilët nga malet e mëposhtëm janë malet më të vjetër të rruzullit tokësorë?

- A) Malet e Skandinavisë
- B) Malet Urale
- C) Malet Himalaje
- D) Malet kordiliere

Pyetja 58

Vargjet malore me shtrirje apo formë rrezore janë të lidhura me strukturat:

- A) Antiklinale
- B) Sinklinale
- C) Bllokore
- D) Mbihipëse

Pyetja 59

Ç'është piemonti si formë relievi?

- A) Fushëgropë grabenore

- B) Rrafsh në lartësi malore
- C) Fushë aluvionale në rrëzë të maleve
- D) Fushë në një luginë lumore

Pyetja 60

Cila është faza e tretë e evolucionit të piemontit?

- A) Formimi i glacis aluvional
- B) Oportimi i mbulesës së vjetër aluvionale
- C) Deformimi i sipërfaqes topografike nga kodrat e luginat
- D) Zhdukja e mbulesës së vjetër aluvionale.

Pyetja 61

Cila nga fushat e mëposhtëme të vendit tonë ka tiparet e piemontit?

- A) Fushëgropa e Korçës
- B) Ultësira pranëadriatike
- C) Fusha e Delvinës
- D) Fusha në Luginën e Vjosës së Sipërme

Pyetja 62

Strukturë aklinale do të thotë së është:

- A) Strukturë me palosje nga poshtë (sinklinal)
- B) Strukturë me palosje nga lartë (antiklinal)
- C) Strukturë me rënie nga një krahë
- D) Strukturë e sheshtë e padeformuar

Pyetja 63

Pse në krahun perëndimor strukturat tektonike të Shqipërisë kanë karakter monoklinal?

- A) Për shkak të lëvizjeve tektonike me karakter rrudhosës
- B) Për shkak të lëvizjeve tektonike horst-grabën
- C) Për shkak të lëvizjeve tektonike me karakter mbihipje
- D) Për shkak të lëvizjeve që kanë formuar horstantiklinale

Pyetja 64

Në cilën tip strukture tektonike formohen kuestet?

- A) Rrudhosëse
- B) Horst-graben
- C) Të sheshtë
- D) Monoklinale

Pyetja 65

Nëse midis shtresave shkëmbore të strukturës monoklinale ka ndryshime të theksuara të trashësisë çfarë lloj forme relievi formohet?

- A) Shkallë strukurore
- B) Taracë denudative

- C) Shkallë tektonike
- D) Taracë akumulative

Pyetja 66

Në cilin nga kushtet e mëposhtëme formohet luginë e tipit konsekuent?

- A) Kur lugina e lumit zhvillohet në drejtim të kundërt të rënies së shtresave
- B) Kur lugina e lumit zhvillohet në drejtim të njëjtë me rënien e shtresave
- C) Kur lugina e lumit zhvillohet në drejtimin normal me rënien e shtresave
- D) Kur lugina e lumit zhvillohet duke prerë një strukturë antiklinale

Pyetja 67

Në cilin nga rastet e mëposhtme kemi mospërputhje e relievit me strukturën:

- A) Kur lugina është zhvilluar në sinklinal
- B) Kur lugina është zhvilluar në graben
- C) Kur lugina është zhvilluar në antiklinal
- D) Kur lugina është zhvilluar në monoklinal

Pyetja 68

Çfarë tip relievi formojnë mbylljet periklinale?

- A) Reliev malor
- B) Reliev luginor
- C) Reliev gropor
- D) Reliev kodrinor

Pyetja 69

Çfarë tip relievi nga pikpamja gjenetike janë badlandet (tokat e këqija)?

- A) Reliev lumor
- B) Reliev strukturor
- C) Reliev karstik
- D) Reliev denudues

Pyetja 70

Çfarë lloje veprimtarie kuptojmë me procese denuduese?

- A) Veprimtarinë gërryese të lumenjve dhe përrenjve
- B) Veprimtarinë tretëse të ujërave rrjedhës
- C) Lëvizja e materialeve nëpër shpate për shkak të peshës
- D) Lëvizjen e materialeve nëpër shpate nga rrjedhjet ujore

Pyetja 71

Si bëhet zhvendosja e materialeve gjatë dukurisë së shëmbjes?

- A) Në formë të menjëhershme nga lart - poshtë
- B) Në formë rryma baltrash dhe selesh
- C) Në formë zvarritjeje përgjatë shpatit
- D) Në formë kërcimesh në pjesë të ndryshme të shpatit

Pyetja 73

Sa është pjerrësia e shpatit për ndodhjen e zakonshme të rrëshqitjeve?

- A) 20 - 35 gradë
- B) 10 - 15 gradë
- C) 30 - 45 gradë
- D) Mbi 45 gradë

Pyetja 74

Në cilët lloj shkëmbinjsh janë më të përhapura rrëshqitjet?

- A) Gëlqerorë
- B) Ranorë
- C) Magmatikë
- D) Argjilorë

Pyetja 75

Në cilat kushte ndodh soliflaksioni në formë thjerrzash?

- A) Në koren e alterimit të përbërë nga copra të mëdha
- B) Në formimet argjilore në kufijtë e plasticitetit
- C) Në shpatet e mbuluara nga konet koluvialë
- D) Në shpatet e përbëra nga materiale kompakte

Pyetja 76

Në cilën tip klime ndodhin më shumë rrymat e baltrave?

- A) Në klimën e nxehtë
- B) Në klimën mesatare
- C) Në klimën arktike
- D) Në klimën subarktike

Pyetja 77

Cila është shtresa e parë e atmosferës?

- A) Stratosfera
- B) Troposfera
- C) Mezosfera
- D) Termosfera

Pyetja 78

Sa është lartësia e troposferës në stinën e verës në ekuator?

- A) 15 km
- B) 16 km
- C) 17 km
- D) 18 km

Pyetja 79

Sa është lartësia mesatare e stratosferës?

- A) 12 - 80 km
- B) 14 - 84 km
- C) 15 - 90 km
- D) 16 - 96 km

Pyetja 80

Në cilën lartësi të stratosferës temperatura e ajrit fillon e ngrihet?

- A) Në lartësinë 13-14 km
- B) Në lartësinë 15-16 km
- C) Në lartësinë 17-18 km
- D) Në lartësinë 19-20 km

Pyetja 81

Nën ndikimin e cilit faktor sipërfaqja e tokës merr ose përfiton më shumë nxehtësi?

- A) Largësisë tokë-diell
- B) Lartësisë mbi nivelin e detit
- C) Pjerrësisë së rrezeve diellore mbi sipërfaqen e tokës
- D) Shpërndarjes tokë-detë

Pyetja 82

Sa herë më e madhe është nxehtësia specifike e ujit në krahasim me atë të tokës?

- A) 2 herë
- B) 3 herë
- C) 4 herë
- D) 5 herë

Pyetja 83

Sa përqind e masës kontinentale të tokës ndodhet në hemisferën jugore?

- A) 14%
- B) 16%
- C) 19%
- D) 21%

Pyetja 84

Deri në sa metra thellësi ngrohet toka nga rrezet e diellit?

- A) 30 m
- B) 25 m
- C) 20 m
- D) 15 m

Pyetja 86

Sa është konstantja diellore që vjen në kufijtë e jashtëm të atmosferës?

- A) 1.983 kal/cm² min
- B) 2.983 kal/cm² min
- C) 3.983 kal/cm² min
- D) 4.983 kal/cm² min

Pyetja 88

Sa është albedoja në sipërfaqen me borë të freskët?

- A) 61 - 65 %
- B) 71 - 75 %
- C) 81 - 85 %
- D) 91 - 95 %

Pyetja 89

Sa është pesha e masës së ajrit në nivelin e detit?

- A) 4.2 kg/m³
- B) 3.2 kg/m³
- C) 2.2 kg/m³
- D) 1.2 kg/m³

Pyetja 90

Sa herë më pak se uji peshon 1 litër ajër në temperaturën 0 gradë Celsius në nivelin e detit?

- A) 573 herë më pak
- B) 673 herë më pak
- C) 773 herë më pak
- D) 873 herë më pak

Pyetja 91

Sa hektopaskal(hPa) vlerësohet gradienti i ndryshimit të presionit me lartësinë?

- A) 1 hPa për cdo 8.3 m
- B) 1.5 hPa për cdo 8.3 m
- C) 2 hPa për cdo 8.3 m
- D) 2.3 hPa për cdo 8.3 m

Pyetja 92

Sa është sipërfaqja e tokës bujqësore në Shqipëri?

- A) 702700 ha
- B) 698780 ha
- C) 588680 ha
- D) 498780 ha

Pyetja 93

Cili është përdorimi më i rëndësishëm i tokave?

- A) Për pylltari dhe kullota
- B) Për urbanizim
- C) Për infrastrukturë rrugore
- D) Për bujqësi dhe kullota

Pyetja 94

Cili nga katër komponentët kryesorë përbërës të tokës zë përqindjen më të madhe në përbërjen e saj?

- A) Komponenti ujë
- B) Komponenti ajër
- C) Komponenti lëndë minerale
- D) Komponenti lëndë organike

Pyetja 95

Sa është numri i specieve botës që janë njohur dhe determinuar nga shkenca?

- A) 12.5 milion
- B) 1.8 milion
- C) 2.8 milion
- D) 15 milion

Pyetja 96

Cili është kuptimi biogeografik i termit "boreale"

- A) Zonë e ftohtë me bimësi që formon pyje koniferë
- B) Zonë e gjerësive mesatare me drurë gjethegjërë
- C) Zonë e gjerësive mesdhetare me bimësi shkurresh
- D) Zonë me dominim të bimësisë barishtore

Pyetja 97

Sa është numri i specieve të bimëve me lule të botës?

- A) Rreth 100 000 specie
- B) Rreth 300000 specie
- C) Rreth 1000000 specie
- D) Rreth 3000000 specie

Pyetja 98

Cili është shkaku kryesor që shkakton dëmtim më të madh të biodiversitetit?

- A) Sëmundje që prekin specie të ndryshme
- B) Gjuetia e pa kontrolluar nga njeriu
- C) Ndryshimi dhe zhdukja e habitateve nga ana e njeriut
- D) Katastrofat e ndryshme natyore

Pyetja 99

Sa është numri i specieve të humbura në një vit vetëm në hapësirën e pyjeve tropikale?

- A) 1000 specie

- B) 2000 specie
- C) 4000 specie
- D) 6000 specie

Pyetja 100

Gradienti i biodiversitetit si dukuri biogeografike do të thotë:

- A) Shtimi i numrit të llojeve të organizmave nga polet drejt ekuatorit
- B) Shtimi i numrit llojeve të organizmave nga ekuatori drejt poleve
- C) Zvogëlimi i numrit të llojeve të organizmave nga polet drejt ekuatorit
- D) Shtimi i llojeve të organizmave nga lartësi të vogla në lartësi të mëdha

Pyetja 101

Në cilat zona gjeografike vegjetacioni është organizuar në mënyrë të shtresëzuar në drejtimin vertikal(bimësi me kate brenda një pylli)?

- A) Në zonat e gjerësive ekuatoriale e tropikale
- B) Në zonat e gjerësive mesatare e ekuatoriale
- C) Në zonat e gjerësive të ftohta subpolare e mesatare
- D) Në zonat e gjerësive polare e subpolar

Pyetja 102

Kush nga studiuesit e mëposhtëm e konstatoi dhe e përcaktoi dukurinë "hotspotet e biodiversitetit"?

- A) David Currie
- B) Viviane Paquin
- C) Norman Myers
- D) Nigel Stork

Pyetja 103

Nëse i bashkojmë të gjitha zonat e vecanta të tokës të quajtura hotspotet e biodiversitetit, sa % të sipërfaqes së tokës zënë?

- A) 4,32% të sipërfaqes së tokës
- B) 3,32% të sipërfaqes së tokës
- C) 2,32% të sipërfaqes së tokës
- D) 1,32% të sipërfaqes së tokës

Pyetja 104

Të gjitha zonat e tokës që janë vlerësuar si hotspotet e biodiversitetit mbajnë një fond të caktuar të biodiversitetit. Sa përqind është ky fond?

- A) 40%
- B) 50%
- C) 60%
- D) 70%

Pyetja 105

Cili nga përcaktimet e mëposhtme i takon grupit taksonomik "specie"?

- A) Grup organizmash me ndryshime në pamjen fizike që kryqëzohen brenda grupit
- B) Grup organizmash me ndryshime gjenetike që kryqëzohen brenda grupit
- C) Grup organizmash me individë të ngjajshëm dhe që kryqëzohen brenda grupit
- D) Grup organizmash me një numër të caktuar individësh që jetojnë në një habitat

Pyetja 106

Çfarë kuptojmë me termin "areal"?

- A) Një hapësirë gjeografike ku jeton një organizëm
- B) Një hapësirë gjeografike ku jeton një njësi taksonomike
- C) Një territor që përdoret nga organizmat vetëm për riprodhim
- D) Një territor i papërshtatshëm për jetën e organizmave

Pyetja 107

Cilat janë kushtet karakteristike mjedisore në të cilat zhvillohen bimët mezofite?

- A) Kushte ndricimi të plotë dhe tokë e thatë
- B) Lagështi e madhe kombinuar me periudha thatësie
- C) Kushte me lagështi mesatare dhe hije gjatë vitit
- D) Kushte mjedisore pak të lagështa dhe me hije

Pyetja 108

Çfarë quhet bashkëjetesa e disa lloje organizmash në një shoqërim?

- A) Biocenoza
- B) Biomë
- C) Ekosistem
- D) Biosferë

Pyetja 109

Cili është niveli i parë ushqyes i zinxhirit ushqimor?

- A) Herbivorët
- B) Karnivorët
- C) Detritorët
- D) Producentët

Pyetja 110

Sa përqind e energjisë së trupit të tyre përdorin kafshët?

- A) 0.1 deri 10%
- B) 11.1% - 20%
- C) 20.1% - 30%
- D) 30.1% - 40%

Pyetja 111

Ç'është tipi i rrugës të lëvizjes së organizmave e quajtur "koridori filtër"?

- A) Koridor me varietet të madh habitatesh

- B) Koridor me varietet të kufizuar habitatesh
- C) Rrugë ku organizmat lëvizin aksidentalisht
- D) Rrugë ku organizmat lëvizin me ndihmën e njeriut

Pyetja 112

Ku konsiston "Ligji i minimumit" i fiziologut gjerman Liebig?

- A) Elementet ushqyes mungues të organizmit mund të zëvendësohen
- B) Një faktor kufizues për një organizëm të caktuar është vdekjeprurës për të
- C) Nuk kanë rëndësi elementet përbërës të biotopit se organizmat përshtaten
- D) Nëse mungon një element ushqyes i domosdoshëm zhvillimi normal ndërpritet

Pyetja 113

Ku konsiston pasoja më e zakonshme e një konkurrence të fortë dhe efiçente midis organizmave?"

- A) Njeri prej organizmave mund të largohet nga ai territor (habitat)
- B) Njëri nga organizmat mund të zhduket për shkak të përjashtimit nga territori
- C) Organizmi më i dobët mund të mbijetojë në atë territor me mungesa ushqimore
- D) Organizmi më i dobët mund të ndryshojë dietë ushqimore për të mbijetuar

Pyetja 114

Ç'është dukuria e komensalizmit si faktor biotik?

- A) Formë e konkurrencës
- B) Formë e simbiozës
- C) Forme e parazitizmit
- D) Formë e grabitshmërisë

Pyetja 115

Ç'është specia kyçe në një ekosistem?

- A) Një specie dominuese në ekosistem
- B) Një specie konkurruese e të gjitha të tjerave
- C) Një specie e domosdoshme për jetën e të tjerave
- D) Një specie në simbiozë me speciet e tjera

Pyetja 116

Ekologjist britanik Charles Elton në vitin 1950 studioi:

- A) Lidhjen midis biodiversitetit dhe funksionimit të ekosistemit
- B) Lidhjet midis komuniteteve të bimëve në ekosistem
- C) Tolerancat klimatike të organizmave në ekosistem
- D) Rolin e organizmave kyç në ekosistem

Pyetja 117

Në cilën temperaturë drurët gjetherënës të klimës mesatare pësojnë dëmtime fizike e fiziologjike?

- A) Në temperaturën -20 gradë Celsius

- B) Në temperaturën -30 gradë Celsius
- C) Në temperaturën -40 gradë Celsius
- D) Në temperaturën -50 gradë Celsius

Pyetja 118

Në cilën temperaturë u bazua Colin Prentice në studimet e tij për të përcaktuar tolerancën termike të formacioneve të ndryshme bimore?

- A) Në temperaturën mesatare vjetore
- B) Në temperaturën minimale
- C) Në temperaturën maksimale
- D) Në amplitudën termike mesatare

Pyetja 119

Cila është ngarja kryesore natyrore që ka ndodhur gjatë periudhës së Holocenit?

- A) Një fazë e rëndësishme e akullzimit
- B) Lëvizje të fuqishme ngritëse të relievit
- C) Fillimi i stabilizimit të klimës që kemi sot
- D) Regresione të fuqishme detare

Pyetja 120

Deri sa përqind (në raste të skajshme) mund ta reduktojnë retë ndriçimin që vjen në atmosferë nga rrezatimi diellor?

- A) Deri 65%
- B) Deri 75%
- C) Deri 85%
- D) Deri 95%

Pyetja 121

Ç'janë lëvizjet luhatëse ose ndryshe epeirogjenike ?

- A) Lëvizje të ngadalëshme ngritëse dhe ulëse të kontinenteve dhe fundeve oqeanike
- B) Lëvizje të ngadalëshme me zhvendosje horizontale të kontinenteve dhe fundeve oqeanike
- C) Lëvizje me diferencime të mëdha vertikale të pjesëve të mëdha kontinentale
- D) Lëvizje me diferencime të mëdha vertikale të fundeve(tabaneve) oqeanike

Pyetja 122

Lëvizjet izostatike janë të lidhura me:

- A) Largimin e ujërave nëntokësorë nga shtresat e tokës si pasojë e shrytëzimit
- B) Shrytëzimin e pasurive nëntokësore dhe krijimin e boshllëqeve të mëdha
- C) Lehtësim ose rëndim mbi sipërfaqen e tokës nga akullnajat dhe erozioni
- D) Pakësim i masës së ujërave detarë e oqeanikë për arsye klimatike

Pyetja 123

Në rast se distanca midis kreshtave të zonave që erodohen dhe zonave të depozitimit është e madhe, çfarë lloj strukturash mund të formohen në kontinente?

- A) Struktura të tipit graben
- B) Struktura të tipit kube
- C) Struktura të tipit sinklinal
- D) Struktura të tipit monoklinal

Pyetja 124

Lëvizjet eustatike të nivelit të oqeanit botëror janë:

- A) Lëvizje që përfshijnë gjithë sipërfaqen oqeanit botëror
- B) Lëvizje që përfshijnë zona të caktuara të oqeanit botëror
- C) Lëvizje që shfaqen herë në një oqean e herë në një tjetër
- D) Lëvizje që shfaqen vetëm në zonën e takimit të pllakave tektonike

Pyetja 125

Deri sa metra do të ngrihej niveli i oqeanit botëror nëse do të shkriheshin gjithë akullnajat dhe akujt që gjenden aktualisht në sipërfaqen e tokës?

- A) Deri 40 m
- B) Deri 50 m
- C) Deri 60 m
- D) Deri 70 m

Pyetja 126

Cili nga pohimet e mëposhtëm për ndikimin e regresioneve detare nuk është i vërtetë?

- A) Ndikojnë në rritjen e kontinentalitetit të klimës
- B) Ndikojnë në bashkimin e ishujve me kontinentin
- C) Ndikojnë në ndryshime të dukshme të vijës bregdetare
- D) Ndikojnë në rritjen e erozionit të dallgëve detare

Pyetja 127

Cili nga pohimet e mëposhtme për ndikimin e transgresioneve detare nuk është i vërtetë?

- A) Ndikojnë në rritjen e erozionit të ujërave sipërfaqësore
- B) Ndajnë pjesë të kontinentit dhe formojnë ishuj
- C) Ndikojnë në rritjen e zonave me klimë oqeanike
- D) Rrisin vështirësitë për lëvizjen e kafshëve tokësore

Pyetja 128

Sa është ngritja mesatare vjetore e nivelit të oqeanit botëror bazuar në mendimin e shumicës së specialistëve?

- A) 1.1 m/m
- B) 1.5 m/m
- C) 1.8 m/m
- D) 2 m/m

Pyetja 129

Në cilën periudhë gjeologjike ka ekzistuar Pangea?

- A) Në periudhën e Karboniferit
- B) Në periudhën e Permianit
- C) Në periudhën e Triasit
- D) Në periudhën e Kretës

Pyetja 130

Çfarë dukurie ndodh në kontaktin e një pllake tektonike oqeanike me një pllakë tektonike kontinentale?

- A) Pllaka tektonike kontinentale zhytet apo zbret më poshtë
- B) Pllaka tektonike oqeanike zhytet apo zbret më poshtë
- C) Të dy pllakat shtyhen me njëra-tjetrën dhe ndodh deformim
- D) Të dy pllakat tektonike ngihen lartë në frontin e takimit.

Pyetja 131

Sa është shpejtësia vjetore e lëvizjes së pllakave kontinentale?

- A) 2-3 cm/vit
- B) 4-5 cm/vit
- C) 6-7 cm/vit
- D) 8-9 cm/vit

Pyetja 132

Në çfarë mënyre janë formuar malet në tokë para coptimit të Pangeas?

- A) Njëpërmjet forcave që kanë vepruar gjatë rrotullimit të tokës
- B) Njëpërmjet forcave tërheqëse nga trupa të tjerë qiellorë
- C) Njëpërmjet zhvillimit të zonave gjeosinklinale - orogjenike
- D) Njëpërmjet zhvillimit të proceseve të ndryshme të magmatizmit

Pyetja 133

Përveç teorisë së lëvizjes së pllakave kontinentale njihet edhe teoria e zgjerimit të tokës e cila konsiston:

- A) Në rritjen e tokës në drejtim të dy poleve
- B) Në rritjen e lartësisë së zonave malore
- C) Në rritjen e rrezes dhe volumit të tokës
- D) Në zgjerimin e gropave oqeanike e detare

Pyetja 134

Përcaktoni se cili nga pohimet e mëposhtëm është i gabuar:

- A) Gjatë zgjerimit të tokës ndodh pakësimi i shpejtësisë së rrotullimit
- B) Zgjerimi i tokës shoqërohet me dukurinë e zgjatjes së ditës dhe natës
- C) Zgjerimi i tokës shoqërohet me pakësimin e numrit të ditëve në një vit
- D) Zgjerimi i tokës shoqërohet me rritje të kontinenteve dhe zvogëlim të oqeanëve

Pyetja 135

Shkencëtari japonez Gorai mendon se që nga pas mesozoit Toka është zgjeruar:

- A) 1500 km
- B) 1400 km
- C) 1300 km
- D) 1200 km

Pyetja 136

Shkencëtari japonez Gorai mendon se që nga pas mesozoi volumi i tokës është rritur:

- A) 1 herë
- B) 1.5 herë
- C) 2 herë
- D) 2.5 herë

Pyetja 137

Është llogaritur se si rezultat i zgjerimit, shpejtësia e rrotullimit të tokës rreth vehtes pakësohet mesatarisht:

- A) 0.5 milisekond në 100 vjet
- B) 1 milisekonda në 100 vjet
- C) 1.5 milisekonda në 100 vjet
- D) 2 milisekonda në 100 vjet

Pyetja 138

Sipas studimeve shkencore rezulton se pakësimi i shpejtësisë së rrotullimit prej 2 milisekonda në 100 vjet i korespondon një zgjerimi të tokës prej:

- A) 60 m/m në vit
- B) 70 m/m në vit
- C) 80 m/m në vit
- D) 90 m/m në vit

Pyetja 139

Në cilën prej këtyre tip lëvizjesh të kores së tokës përgjithësisht nuk kemi formim të maleve?

- A) Në kushtet e lëvizjeve zgjeruese të tokës
- B) Në kushtet e lëvizjeve vertikale(radiale)
- C) Në kushtet e lëvizjeve të ripërritjes
- D) Në kushtet e lëvizjeve horizontale(tagenciale)

Pyetja 140

Sa përqind të gjithë zonave malore të globit zënë malet me origjinë tektonike?

- A) 75 %
- B) 80 %
- C) 85 %
- D) 90 %

Pyetja 141

Çfarë thellësie kanë tërmetet që klasifikohen tërmete me vatra normale?

- A) deri në 70 km
- B) deri në 80 km
- C) deri në 90 km
- D) deri në 100 km

Pyetja 142

Çfarë thellësie kanë tërmetet që klasifikohen tërmete me vatra të ndërmjetme?

- A) 501-700 km
- B) 301-500 km
- C) 70- 300 km
- D) 1 – 69 km

Pyetja 143

Çfarë thellësie kanë tërmetet që klasifikohen si tërmete me vatra plutonike?

- A) 1- 299 km
- B) 300- 600 km
- C) 601- 700 km
- D) 701- 800 km

Pyetja 144

Cili nga elementet e mëposhtëm që karakterizojnë vatrën e tërmetit është i gabuar (pra nuk ekziston si element)?

- A) Sipërfaqja
- B) Magnituda
- C) Energjia
- D) Deformimi

Pyetja 145

Sa është diferenca e energjisë nga njëra shkallë e magnitudës në tjetrën për shkallën Rihter?

Sa është diferenca e energjisë nga njëra shkallë e magnitudës në tjetrën për shkallën Rihter?

- A) 11- 20 herë
- B) 21- 30 herë
- C) 31-40 herë
- D) 41-50 herë

Pyetja 146

Sa shkallë Rihter kanë arritur tërmetet më të fuqishëm që kanë ndodhur në tokë?

- A) deri 7.6 shkallë Rihter
- B) 7.7 - 8.6 shkallë Rihter
- C) 8.7 - 9.6 shkallë Rihter
- D) Mbi 9.6 shkallë Rihter

Pyetja 148

Për ta konceptuar më mirë energjinë e çliruar nga një tërmet i fortë bëhet krahsimi me bombat atomike. Me sa bomba atomike është afërsisht e barabartë energjia e çliruar nga një tërmet i fortë?

- A) E barabartë me 11200 bomba atomike
- B) E barabartë me 12000 bomba atomike
- C) E barabartë me 12500 bomba atomike
- D) E barabartë me 13000 bomba atomike

Pyetja 149

Cili nga përcaktimet e mëposhtëm mbi llojet e valëve që transmetohen nga vatra e tërmetit është i gabuar?

- A) Valë sizmike gjatësore
- B) Valë sizmike të shkurtra
- C) Valë sizmike tërthore
- D) Valë sizmike sipërfaqësore

Pyetja 150

Zakonisht, prej cilës shkallë fillojnë shkatërrimet në sipërfaqen e tokës?

- A) Prej shkallës 5 ballë
- B) Prej shkallës 6 ballë
- C) Prej shkallës 7 ballë
- D) Prej shkallës 8 ballë

Pyetja 151

Në varësi nga përbërja e truallit ndryshon edhe ndjeshmëria e tërmetit që reflektohet në dëme në sipërfaqe. Sa herë më i fuqishëm mund të ndjehet tërmeti në rërat bregdetare në krahasim me territoret shkëmbore të qëndrueshme?

- A) 1-1.5 herë
- B) 2 herë
- C) 2 -3 herë
- D) 3-5 herë

Pyetja 152

Sa është lartësia maksimale që mund të arrijnë valët "tsunami"?

- A) deri 30 m
- B) Deri 25 m
- C) Deri 20 m
- D) Deri 15 m

Pyetja 153

Sa është shpejtësia e lëvizjes përparuese drejt bregut e valëve "tsunami"?

- A) 14 km/minutë

- B) 12 km/minutë
- C) 10 km/minutë
- D) 8 km/minutë

Pyetja 154

Në brigjet e cilit oqean janë më të zakonshme "Tsunamet"?

- A) Oqeanit Indian
- B) Oqeanit Atlantik
- C) Oqeanit Paqësor
- D) Oqeani i Ngrirë i Veriut

Pyetja 155

Cila nga pjesët e shënuara më poshtë dallohet për sizmicitet të lartë?

- A) Mburoja kanadeze
- B) Mburoja braziliane
- C) Zona periferike e Paqësorit
- D) Australia Perëndimore

Pyetja 156

Ç'janë format vullkanike "nekuri" të cilat quhen kështu në Afrikën e Jugut dhe në Skoci?

- A) Trupa vullkanik të formuar në anët e kanalit vullkanik
- B) Trupa vullkanik që janë formuar në bazën e konit vullkanik
- C) Mbetje të kanaleve vullkanik pas erozionit që ndodh në kon
- D) Forma relievi të formuara nga erozioni në shpatet e konit

Pyetja 157

Në rastin e një vullkani cilat produkte dalin më parë në sipërfaqe?

- A) Produktet e lëngëta
- B) Produktet e gasta
- C) Bombat vullkanike
- D) Hiri vullkanik

Pyetja 158

Sa përqind e produkteve vullkanike janë zakonisht avuj uji?

- A) Rreth 75%
- B) Rreth 55%
- C) Rreth 35%
- D) Rreth 25%

Pyetja 159

Shkencëtarët kanë llogaritur afërsisht volumin e produkteve të ngurta që vullkanet kanë sjellë në sipërfaqen e tokës. Sa është ky volum që nga viti 1600 deri sot?

- A) 300 km³
- B) 250 km³

- C) 200 km³
- D) 170 km³

Pyetja 160

Ç'janë lapilet si produkte vullkanike?

- A) Copra hiri vullkanik të ngjeshura në ajër
- B) Copra gurësh vullkanik të madhësive të ndryshme
- C) Copra të vogla llave të ngurtësuara në ajër
- D) Copra të formuara nga rëra të lidhura me material tjetër

Pyetja 161

Në cilën masë të përbërjes prej silici, llava quhet acide dhe është më pak e lëngshme?

- A) mbi 35 % silic
- B) mbi 45 % silic
- C) mbi 55 % silic
- D) mbi 65% silic

Pyetja 162

Në cilën zonë ndodhen 80% të vullkaneve të tokës?

- A) Në Unazën e Oqeanit Paqësor
- B) Në brezin meridional të Atlantikut
- C) Në brezin e Afrikës Lindore
- D) Në brezin mesdhetar

Pyetja 163

Cili nga gazet e poshtshënuar është në sasi më të madhe në përbërjen e atmosferës?

- A) Oksigjeni
- B) Hidrogjeni
- C) Azoti
- D) Argoni

Pyetja 164

Sa është përqindja e oksigjenit në atmosferë?

- A) 20.948 %
- B) 19.958 %
- C) 18.968 %
- D) 17.978 %

Pyetja 165

Sa është përqindja e dioksidit të karbonit(CO₂) në atmosferë?

- A) 0.0353 %
- B) 0.0235 %
- C) 0.0135 %
- D) 0.0035 %

Pyetja 166

Në cilin nga territoret e mëposhtëm është më e lartë prezenca e dioksidit të karbonit?

- A) Mbi hapësirat oqeanike
- B) Në hapësirat polare
- C) Në hapësirën e Antaktidës
- D) Në gjerësitë mesatare të kontinentit

Pyetja 167

Cili nga përbërësit e mëposhtëm zë përqindjen më të madhe në përbërjen e diellit?

- A) Karboni
- B) Heliumi
- C) Neoni
- D) Hidrogjeni

Pyetja 168

Cili nga përcaktimet e mëposhtme për rrezatimin e drejtpërdrejt është gabim?

- A) Rrezatimi diellor zvogëlohet në kushtet e transparencës së ulët
- B) Rrezatimi diellor zvogëlohet me rritjen e lartësisë mbi nivelin e detit
- C) Rrezatimi diellor rritet nga ekuatori në gjerësitë më të mëdha gjeografike
- D) Rrezatimi diellor zvogëlohet me rritjen e pjerrësisë së relievit

Pyetja 169

Çfarë dukurie lidhur me rrezatimin diellor shprehet me anën e formulës $A=Rr/Q$?

- A) Rrezatimi diellor i drejtpërdrejt
- B) Rrezatimi diellor i shpërndarë
- C) Rrezatimi diellor i reflektuar
- D) Shuma e rrezatimit diellor

Pyetja 170

Sa është temperatura mesatare vjetore e sipërfaqes së tokës?

- A) 120°C
- B) 130°C
- C) 140°C
- D) 150°C

Pyetja 171

Çështje inversioni termik?

- A) Temperaturë më e lartë natën se sa ditën
- B) Temperaturë më e lartë në mëngjes se sa në mesditë
- C) Temperaturë më e lartë në mal se në fushë
- D) Temperaturë më e ulët afër sipërfaqes së tokës se sa në lartësi

Pyetja 173

Cila nga lidhjet e mëposhtme temperaturë-lagështi relative është e gabuar?

- A) Temperatura 16°C, lagështia relative 50%
- B) Temperatura 30 °C, lagështia relative 70%
- C) Temperatura 5°C, lagështia relative 100%
- D) Temperatura 20°C, lagështia relative 45%

Pyetja 174

Sa arrin sasia e lagështisë absolute në zonat ekuatoriale dhe subtropikale?

- A) 18gr/m³
- B) 20gr/m³
- C) 30gr/m³
- D) 35gr/m³

Pyetja 175

Sa është lagështia relative e ajrit në zonat ekuatoriale?

- A) 80%
- B) 85%
- C) 90%
- D) 95%

Pyetja 176

Cila është njësia matëse e tensionit të avujve të ujit që gjenden në atmosferë?

- A) %
- B) gr/m³
- C) gr/kg
- D) mb

Pyetja 177

Në cilat nga zonat e poshtshënuara trysnia atmosferike është në vlerat 1026 deri 1035 mb?

- A) Në zonën ekuatoriale të trysnisë
- B) Në zonën subtropikale të trysnisë
- C) Në zonën e tretë të trysnisë
- D) Në zonën polare të trysnisë

Pyetja 178

Në cilën gjerësi gjeografike vlera e trysnisë atmosferike është 758 dhe 756 m/m?

- A) Në gjerësinë 0-50
- B) Në gjerësitë 30-350
- C) Në gjerësitë 50-600
- D) Në gjerësitë mbi 600

Pyetja 179

Nëse temperatura rritet 1 gradë C, sa rritet shkalla barike?

- A) 0.2%
- B) 0.3%
- C) 0.4%
- D) 0.5%

Pyetja 180

Cili nga përcaktimet e mëposhtme në lidhje me tipet e masave ajrore është gabim?

- A) Masa ajrore polare
- B) Masa ajrore arktike
- C) Masa ajrore ekuatoriale
- D) Masa ajrore subekuatoriale

Pyetja 181

Në cilin nga kontaktet midis dy tipeve të masave ajrore ndryshimet termike janë më të theksuara dhe dinamika është më intensive?

- A) Midis masës ajrore ekuatoriale dhe tropikale
- B) Midis masës ajrore tropikale dhe polare
- C) Midis masës ajrore polare dhe arktike
- D) Midis masës ajrore ekuatoriale dhe polare

Pyetja 182

Kur fronti midis dy masave ajrore në kontakt quhet front i ftohtë?

- A) Kur ajri i ngrohtë lëviz në drejtim të ajrit të ftohtë
- B) Kur ajri i ftohtë lëviz në drejtim të ajrit të ngrohtë
- C) Kur fronti i ngrohtë lëviz ngadaltë dhe sjellë shira dhe borë
- D) Kur fronti i ftohtë e shpëput plotësisht nga toka masën e ajrit të ngrohtë

Pyetja 183

Nga kontakti i cilave masa ajrore formohet fronti polar?

- A) Masa ajrore tropikale me ato polare
- B) Masa ajrore tropikale me ato ekuatoriale
- C) Masa ajrore polare me ato arktike
- D) Masa ajrore tropikale me ato arktike

Pyetja 184

Në stinën e verës fronti polar zhvendoset drejt veriut dhe vendoset në gjerësitë 40-60°. Në këtë zonë formohen disa fronte dytësore. Cili nga frontet e mëposhtëm është gabim?

- A) Fronti i Oqeanit Paqësor
- B) Fronti i Europës Lindore
- C) Fronti i Azisë Lindore
- D) Fronti i Azisë së Mesme

Pyetja 185

Fronti polar vepron edhe në Shqipëri, në periudhën e ftohtë të vitit. Sa përqind është rastisja e veprimit të këtij fronti në vendin tonë?

- A) 45.3%
- B) 55.3%
- C) 65.3%
- D) 75.3%

Pyetja 186

Cila nga thëniet e mëposhtme është e vërtetë?

- A) Puhija detare është erë karakteritike e stinës së ftohtë
- B) Puhija detare është një erë që sjell reshje atmosferike
- C) Puhija detare rezulton nga ndryshimi termik midis tokës dhe detit
- D) Puhija detare është një erë e fortë dhe mundëson prodhim energjie

Pyetja 187

Në cilin nga këto vende fryn më fort (është më e njohur) era me emrin bora ose murlani?

- A) Në brigjet adriatike të Triestes
- B) Në brigjet adriatike të Kroacisë
- C) Në brigjet adriatike të Shqipërisë
- D) Në brigjet joniane të Greqisë

Pyetja 188

Çfarë kuptojmë me qarkullim të përgjithshëm të atmosferës?

- A) Lëvizjen e të gjitha rrymave ajrore në shkallë kontinentale
- B) Lëvizjen e të gjitha rrymave ajrore në shkallë rajonale
- C) Lëvizjen e të gjitha rrymave ajrore në shkallë lokale
- D) Lëvizjet e të gjitha llojeve të rrymave ajrore

Pyetja 189

Në cilat gjerësi gjeografike forca e Koriolisit, është më e vogël ose mungon?

- A) Në gjerësitë gjeografike mbi mesatare
- B) Në gjerësitë gjeografike mesatare
- C) Në gjerësitë gjeografike tropikale
- D) Në gjerësitë gjeografike ekuatoriale

Pyetja 190

Cili nga përcaktimet e mëposhtme lidhur me pasatet është i vërtetë?

- A) Pasatet dallohen për paqendrueshmëri të drejtimit të erës
- B) Zona e pasateve dallohet për qendrueshmëri të stratifikimit
- C) Gjithë zona e pasateve dallohet për reshje të bollshme
- D) Shpejtësia e lëvizjes së erave të pasateve është 25-35km/orë

Pyetja 191

Në cilat gjerësi gjeografike zhvillohen dhe lëvizin erërat perëndimore?

- A) Në gjerësitë ekuatoriale
- B) Në gjerësitë tropikale
- C) Në gjerësitë mesatare
- D) Në gjerësitë subpolare

Pyetja 192

Në cilën prej këtyre masave ajrore era lëviz me shpejtësi deri në 500 km/orë

- A) Në ciklonet tropikalë
- B) Në ciklonet jashttropikalë
- C) Në musonet tropikalë
- D) Në rrymat rrjedhëse (currilore)

Pyetja 193

Në cilat gjerësi gjeografike ndodhin ciklonet tropikalë?

- A) Në gjerësitë 5-10 gradë
- B) Në gjerësitë 10-20 gradë
- C) Në gjerësitë 15-25 gradë
- D) Në gjerësitë 25-35 gradë

Pyetja 195

Sa është gjerësia më e zakonshme zhvillimit të një tornadoje?

- A) 100m – 1.5 km
- B) 1.6 km – 2 km
- C) 2.1 km – 2.5 km
- D) 2.6 km – 3 km

Pyetja 196

Sa është shpejtësia mesatare e lëvizjes (spostimit) të një tornadoje?

- A) 18-31 m/sekondë
- B) 32-44 m/sekondë
- C) 45-58 m/sekondë
- D) 59-72 m/sekondë

Pyetja 197

Cila është zona më karakteristike e ndodhjes së tornadove të cilat shoqërohen edhe me dëme të mëdha?

- A) Veriu i Europës
- B) Afrika Jugore
- C) Perëndimi i Mesëm i SHBA
- D) Australia Juglindore

Pyetja 198

Cili nga tipet e mëposhtëm të klimës nuk bën pjesë në klasifikimin klimatik të Kejpenit?

- A) Klimë tropikale e lagët

- B) Klimë e thatë
- C) Klimë e ftohtë me borë
- D) Klimë mesdhetare

Pyetja 199

Në sa tipe klimash konsiston klasifikimi klimatik i Bergut?

- A) 7 tipe
- B) 9 tipe
- C) 11 tipe
- D) 13 tipe

Pyetja 200

Në përcaktimet e mëposhtme shënoni përgjigjen e saktë që i përgjigjet pjesës veriore të klimës mesatare kontinentale:

- A) Radiacioni diellor është i vogël, avullimi është më i pakët se sa rënia e reshjeve
- B) Radiacioni diellor është i lartë, avullimi i rritur dhe sasia e reshjeve afrohet me normalen
- C) Radiacioni diellor është më i lartë, sasia e reshjeve pakësohet, lagështia e pamjaftueshme
- D) Radiacioni diellor shumë i lartë, avullimi rritet shumë dhe lagështia e tokës është e pakët

Pyetja 201

Për shkak të bashkëveprimit të ajrit arktik dhe ajrit tropikal në pjesën juglindore të Fushës Ruse shfaqen tipe të ndryshëm moti. Cili nga tipet e mëposhtëm nuk është i vërtetë?

- A) Moti mesatarisht i ftohtë
- B) Moti shumë i ftohtë
- C) Moti mesatarisht i ngrohtë
- D) Moti shumë i ngrohtë

Pyetja 202

Sa mund të ulet temperatura e ajrit në pjesën jugore të zonës së klimës mesatare kontinentale në Azi?

- A) -20°C deri -30°C
- B) -30°C deri -40°C
- C) -40°C deri -50°C
- D) -45°C deri -55°C

Pyetja 204

Veçori karakteristike e klimës mesatare kontinentale është amplituda e temperaturës vjetore së ajrit e cila vlerësohet:

- A) Shumë e madhe
- B) E madhe
- C) Shumë e vogël
- D) E vogël

Pyetja 205

Sa përqind e ngrohtësisë harxhohet për avullim në hapësirën e klimës mesatare oqeanike?

- A) 50%
- B) 60%
- C) 70%
- D) 80%

Pyetja 206

Në cilën nga periudhat e mëposhtme është e zhvilluar veprimtaria ciklonike në hapësirën e klimës mesatare oqeanike?

- A) Në të gjitha stinët
- B) Në stinën e dimrit
- C) Në stinën e vjeshtës
- D) Në stinën e pranverës

Pyetja 207

Karakteristika kryesore e klimës subarktike kontinentale është:

- A) Dimri relativisht i ftohtë, vera e shkurtër dhe relativisht e ngrohtë
- B) Dimri i ftohtë, vera e shkurtër dhe e ngrohtë
- C) Dimri shumë i ftohtë, vera e shkurtër dhe relativisht e ngrohtë
- D) Dimri relativisht i ftohtë, vera e shkurtër dhe e ngrohtë

Pyetja 208

Sa është sasia mesatare vjetore e reshjeve në pjesën më të madhe të zonës së klimës subtropikale kontinentale?

- A) 400 m/m
- B) 500 m/m
- C) 600 m/m
- D) 700 m/m

Pyetja 209

Cila është karakteristika kryesore e klimës subtropikale kontinentale?

- A) Vera e freskët dhe e thatë, dimri i paqëndrueshëm dhe relativisht i ftohtë
- B) Vera e nxehtë dhe e lagësht, dimri i paqëndrueshëm dhe relativisht i ftohtë
- C) Vera e nxehtë dhe e thatë, dimri i paqëndrueshëm dhe shumë i ftohtë
- D) Vera e nxehtë dhe e thatë, dimri i paqëndrueshëm dhe relativisht i ftohtë

Pyetja 210

Cila nga karakteristikat e periudhës së optimumit klimatik pas akullnajor nuk është e vërtetë?

- A) Faza kulmore e kësaj periudhe ka qenë 7000-5000 vjet më parë
- B) Temperatura e ajrit në Europë ka qenë 2-3 gradë C më e lartë se sa sot
- C) Niveli i deteve dhe oqeanëve ka qenë 6 m më i lartë se sot
- D) Zona e presionit të lartë subtropikal ka qenë në gjerësitë 40-45 gradë

Pyetja 211

Cila nga karakteristikat klimatike të mëposhtme të periudhës së "shekullit të hekurit" është e vërtetë?

- A) Kjo periudhë ka ekzistuar 1900-1300 vjet më parë
- B) U karakterizua nga ulja e temperaturës dhe shtimi i reshjeve
- C) Në kushtet e klimës së kësaj periudhe zbriti mjaft niveli i liqeneve
- D) Në këtë periudhe kufiri i pyjeve në hemisferën veriore lëvizti drejt veriut

Pyetja 212

Cila nga dukuritë e mëposhtme nuk është e lidhur me akullzimin e Pleistocenit?

- A) Në shpate jugorë dhe vende pranë detare u strehuan specie të ndryshme
- B) Bimësia pyjore e drurëve gjethegjërë transformohet në vegjetacion tundrash
- C) Gjatë periudhës së akullzimit në hemisferë veriore ndodhi një shtim i biodiversitetit
- D) Shumë lloje bimësh e kafshësh lëvizën nga areali i tyre dhe ruajtën popullimin

Pyetja 213

Akullzimi i Pleistocenit ka pasur disa periudha me ndërprerje interglaciale. Kur filloi e mbaroi periudha e fundit e akullzimit të Pleistocenit sipas mendimit dominues shkencor?

- A) Filloi 145 mijë vjet më parë dhe u mbyll 45 mijë vjet më parë
- B) Filloi 135 mijë vjet më parë dhe u mbyll 35 mijë vjet më parë
- C) Filloi 115 mijë vjet më parë dhe u mbyll 10 mijë vjet më parë
- D) Filloi 85 mijë vjet më parë dhe u mbyll 5mijë vjet më parë

Pyetja 214

Gjatë 100 mijë vjetëve të fundit kur klima ka qenë më e ngrohtë dhe më e lagësht gjatë verës se sa sot?

- A) 95 -85 mijë vjet më parë
- B) 85- 74 mijë vjet më parë
- C) 75- 64 mijë vjet më parë
- D) 55-45 mijë vjet më parë

Pyetja 215

Si ishte situata klimatike e Afrikës dhe e Amerikës 15-20 mijë vjet më parë?

- A) Afrika e thatë, Amerika e lagësht
- B) Afrika e lagësht, Amerika e thatë
- C) Afrika e ftohtë, Amerika shumë e ftohtë
- D) Afrika shumë e ngrohtë, Amerika e ngrohtë

Pyetja 216

Kur filloi dhe mbaroi periudha e fundit interglaciale?

- A) Filloi 90 mijë vjet më parë, përfundoi 70 mijë vjet më parë
- B) Filloi 105 mijë vjet më parë, përfundoi 85 mijë vjet më parë
- C) Filloi 120 mijë vjet më parë, përfundoi 100 mijë vjet më parë
- D) Filloi 130 mijë vjet më parë, përfundoi 115 mijë vjet më parë

Pyetja 217

Gjatë cilës periudhë janë stabilizuar kushtet e sotme klimatike të globit?

- A) Miocenit të mesëm
- B) Miocenit të sipërm
- C) Pleistocenit
- D) Holocenit

Pyetja 218

Cili nga deklaramet e mëposhtme lidhur me periudhën interglaciale është gabim?

- A) Karakterizohet nga shtimi i produktivitetit biologjik
- B) Zhvillohen depozitime të buta gjeologjike të karakterit organik
- C) Në depozitime gjenden grimcat e polenit të bimëve
- D) Fundet e liqeneve janë të varfëra më lëndë organike

Pyetja 219

Në cilat tip strukturash tektonike janë kryesisht të zhvilluara kreshtat monoklinale?

- A) Në strukturat sinklinale
- B) Në strukturën horst
- C) Në strukturën e sheshtë
- D) Në strukturën luspore karbonatike

Pyetja 220

Cila nga tipluginat e mëposhtme është zhvilluar në strukturë monoklinale?

- A) Lugina konsekuente
- B) Lugina në linjën e shkëputjes
- C) Lugina në sinklinal
- D) Lugina në antiklinal

Pyetja 221

Nëse një territor karakterizohet nga një stabilitet tektonik gjatë të cilit krijohet sipërfaqja e sheshimit, me sa cikle zhvillohet relievi strukturor?

- A) me 1 cikël
- B) me 2 cikle
- C) me 3 cikle
- D) me 4 cikle

Pyetja 222

Në cilën nga krahinat fiziko-gjeografike të Shqipërisë relievi është në përputhje me strukturën rrudhosëse?

- A) Në Alpet e Shqipërisë
- B) Në Krahinë Malore Qëndrore
- C) Në Krahinën Malore Jugore

D) Në ultësirën Perëndimore

Pyetja 223

Në cilin nga malet e poshtshënuar relievi është në mospërputhje me strukturën?

- A) Në malin e Munellës
- B) Në malin e Thatë
- C) Në malin e Lunxherisë
- D) Në malin e Cukalit

Pyetja 224

Në cilin nga malet e poshtshënuar relievi është në përputhje me strukturën?

- A) Në malin e Pashtrikut
- B) Në malin e Krrabit
- C) Në malin e Polisit
- D) Në malin e Zepës

Pyetja 225

Cila nga luginat e poshtëshënuara është luginë antiklinale?

- A) Lugina e Vjosës së Sipërme
- B) Lugina e Drinit të Zi
- C) Lugina e Devollit
- D) Lugina e Fanit të Vogël

Pyetja 226

Sa gradë është pjerrësia e një plani shkëputjeje normal në fazën fillestare?

- A) 400 gradë
- B) 500 gradë
- C) 600 gradë
- D) 700 gradë

Pyetja 227

Sa gradë është pjerrësia e një plani shkëputjeje pas modelimit të saj nga faktorët e jashtëm?

- A) 251 -299
- B) 300- 350
- C) 351 -399
- D) 400 -450

Pyetja 228

Në cilin tip klime rrëpirat e shkëputjeve nuk kanë tipare të qarta në relievin?

- A) Në klimën e ftohtë e të thatë
- B) Në klimën e ngrohtë e të thatë
- C) Në klimën e ngrohtë e të lagët
- D) Në klimën e ftohtë e të lagët

Pyetja 229

Në rastin e veprimit të njëhershëm të diferencimit tektoogjenik dhe erozionit diferencial çfarë tip rrëpire formohet?

- A) Rrëpirë e shkëputjes
- B) Rrëpirë e linjës së shkëputjes
- C) Rrëpirë komplekse
- D) Rrëpirë litoogjike

Pyetja 230

Ç'është antecedenca si dukuri gjeomorfologjike?

- A) Kur një lum pret një antiklinal gjatë tektoogjenezës
- B) Kur një lum pret një antiklinal me erozion regresiv
- C) Kur një lum pret një penges të ngritur me kalime liqenore
- D) Kur një lum zhvillon veprimtari karstike nëntokësore e sipërfaqësore

Pyetja 231

Në cilat raste apo kushte ndodh mbivendosja e një rrjedhje ujore?

- A) Në rastin kur një rrjedhje pret një strukturë gjeologjike në proces ngritje
- B) Në rastin kur një rrjedhje pret një strukturë gjeologjike në thyerjen tektonike
- C) Në rastin kur një rrjedhje pret shtresën depozituese dhe shtresën e fort posht saj
- D) Në rastin kur një rrjedhje pret një strukturë të ngritur me anë të erozionin regresiv

Pyetja 232

Cili nga opsionet e mëposhtëm lidhur me forcën e rëndesës është i vertetë?

- A) Forca e rezistencës rritet me rritjen e pjerrësisë
- B) Forca e rezistencës zvogëlohet me rritjen e pjerrësisë
- C) Forca e tërheqjes rritet me zvogëlimin e pjerrësisë
- D) Forca e tërheqjes zvogëlohet kur materiali është me copa të mëdha

Pyetja 233

Kur shpati ka një profil transporti?

- A) Kur zhvendosja është më e shpejtë se tjetërsimi
- B) Kur tjetërsimi është më i madh se zhvendosja
- C) Kur materiali i tjetërsuar zhvendoset i tëri
- D) Kur nuk ka as tjetërsim as zhvendosje

Pyetja 234

Si është forma e grumbullimit të materialeve të depozituara nga një shembje?

- A) Në formë të shtresëzuar
- B) Në formë kaotike
- C) Në formë gjuhe
- D) Në formë koni

Pyetja 235

Nëse një masë e madhe materiali zhvendoset në shpat nga lart poshtë sipas një plani, çfarë dukuri gjeomorfologjike kemi në këtë rast?

- A) Shëmbje
- B) Rrëzim
- C) Rrëshqitje
- D) Sele

Pyetja 236

Në cilën tip klime janë më të zakonshme rrëshqitjet?

- A) Në klimën ekuatoriale
- B) Në klimën subekuatoriale të thatë
- C) Në klimën mesatare kontinentale
- D) Në klimën mesdhetare të lagësht

Pyetja 237

Në cilin nga llojet e shkëmbinjve janë më të mundshme ndodhja e rrëshqitjeve?

- A) Në shkëmbinjtë terigjenë
- B) Në shkëmbinjtë gëlqerorë
- C) Në shkëmbinjtë vullkanikë
- D) Në shkëmbinjtë intruziv

Pyetja 239

Sa është sipërfaqja e rrëshqitjes më të madhe që ka ndodhur në Shqipëri?

- A) 200 ha.
- B) 150 ha.
- C) 100 ha.
- D) 50 ha

Pyetja 240

Sa arrin zakonisht thellësia e shtresës që kapet nga rrëshqitja?

- A) 0-5 m
- B) 1-7 m
- C) 2-10 m
- D) 3-15 m

Pyetja 241

Në cilin nga kushtet e mëposhtëme ndodh zakonisht dukuria gjeomorfologjike e quajtur sele?

- A) Kur depozitimet argjilore lëvizin në kufirin e plasticitetit
- B) Kur depozitimet e shkrifta kanë lagështi dhe lëvizin shpejt
- C) Kur materialet e shkrifta kanë brenda dhe blloqe gurësh dhe lëvizin shpejt
- D) Kur materialet që lëvizin përbëhen më shumë nga blloqe gurësh

Pyetja 242

Në cilën tip klime ndodhin më shpesh rrjedhjet e baltrave?

- A) Në klimën e nxehtë të thatë
- B) Në klimën e nxehtë të lagësht
- C) Në klimën mesatare
- D) Në klimën e ftohtë

Pyetja 243

Përrenjtë gurorë si dukuri gjeomorfologjike janë të zhvilluar:

- A) Në zonën klimatike të nxehtë
- B) Në zonën klimatike mesatare
- C) Në zonën klimatike të ftohtë
- D) Në të gjitha zonat klimatike

Pyetja 244

Cila nga dukuritë e mëposhtëme është dukuri solifluskioni?

- A) Rrëshqitjet
- B) Shëmbjet
- C) Rrjedhjet baltore
- D) Rrëzimet

Pyetja 245

Në cilat lloje territoresh ndodhin më shumë lëvizjet e ngadalshme?

- A) Në territoret e përbëra nga karbonatikë
- B) Në territoret e përbëra nga magmatikë
- C) Në territoret e përbëra nga molase
- D) Në territoret e përbëra nga argjilat

Pyetja 246

Veprimtaria kryesore morfologjike e jashtëme që paraqitet si faktori kryesor në modelimin e relievit të sipërfaqes së tokës është:

- A) Veprimtaria karstike
- B) Veprimtaria akullnajore
- C) Veprimtaria lumore
- D) Veprimtaria antropogjene

Pyetja 247

Veprimtaria morfologjike e faktorëve të jashtëm është më e fuqishme:

- A) Kur territori është në qetësi tektonike relative
- B) Kur territori karakterizohet nga ngritja tektonike
- C) Kur territori karakterizohet nga ulja tektonike
- D) Kur territori pëson lëvizje sizmike të herpasheshme

Pyetja 248

Në cilën tip klime zhvillohen sipërfaqet e sheshimit?

- A) Në klimën tropikale
- B) Në klimën ekuatoriale
- C) Në klimën mesatare
- D) Në klimën e ftohtë

Pyetja 249

Një fazë e re gërryerje në thellësi nuk ndodh kur:

- A) Niveli i detit ngrihet
- B) Niveli i detit ulet
- C) Klima bëhet më e lagësht
- D) Territori i lumit ngrihet

Pyetja 250

Pika neutrale e rrjedhjes së një lumi:

- A) Spostohet më lartë në periudhë pake
- B) Spostohet më lartë në periudhë plote
- C) Është gjithmonë e palëvizshme
- D) Lëviz gjithmonë lart gjatë evolucionit të lumit

Pyetja 251

Cili nga elementet morfologjike të një përroi është gabim?

- A) Pellgu ujëmbledhës në sektorin e sipërm
- B) Sektori i mesëm ku bëhet grumbullimi i lëndës
- C) Kanali i rrjedhjes së lëndës në sektorin e poshtëm
- D) Koni i derdhjes së lëndës aty ku përfundon në lum

Pyetja 252

Cilët lloje konesh quhen kone torrencialë?

- A) Konet e depozitimit të formuar nga lumenjtë malorë
- B) Konet e depozitimit të formuar nga lumenjtë në zonë fushore
- C) Kone depozitimi të formuar nga përrenjtë që përfundojnë në një lum
- D) Kone të formuar nga bashkimi i koneve të afërt të disa përrenjëve

Pyetja 253

Cili nga faktorët e mëposhtëm nuk e favorizon zhvillimin e proceseve karstike?

- A) Lartësia mbi nivelin e detit
- B) Prezenca e shkëmbinjve të tretshëm
- C) Mungesa e të çarave në shkëmbinj
- D) Prezenca e mbulesës pyjore

Pyetja 254

Sa % karbonat kalciumi(CaCO_3) përmbajnë gëlqerorët e pastër?

- A) 95%

- B) 85%
- C) 75%
- D) 65%

Pyetja 255

Cili nga shkëmbinjtë e mëposhtëm nuk ekziston?

- A) Gëlqerori merglor
- B) Gëlqerori ranor
- C) Gëlqerori hekuror
- D) Gëlqerori magmatikë

Pyetja 256

Cili nga gëlqerorët e mëposhtëm është shumë më i prirur për procesin karstik normal?

- A) Gëlqerori silicor
- B) Gëlqerori oolitikë
- C) Gëlqerori dolomitikë
- D) Gëlqerori ranor

Pyetja 257

Në cilën trashësi të masivit gëlqeror procesi karstik zhvillohet më mirë?

- A) Në trashësinë 100-200 m
- B) Në trashësinë 200-300 m
- C) Në trashësinë 300-400 m
- D) Në trashësinë mbi 400-500 m

Pyetja 258

Çfarë kuptoni me termin holokarst?

- A) Karst nëntokësor
- B) Karst sipërfaqësor
- C) Karst i pjesshëm
- D) Karst i plotë

Pyetja 259

Në cilën tip strukture është më i zhvilluar karsti i orientuar?

- A) Në strukturën e rrudhosur
- B) Në strukturën masive
- C) Në strukturën shkëputëse
- D) Në strukturën e sheshtë

Pyetja 260

Në cilin nga rastet e mëposhtëm procesi karstik përshpejtohet?

- A) Kur territori karstik pëson ulje tektonike
- B) Kur territori karstik mbulohet nga uji detar
- C) Kur të çarat e shkëmbinjve mbushen me depozitime

D) Kur rritet sasia e reshjeve dhe qarkullimi i ujërave

Pyetja 261

Në cilën tip klime zhvillohet më mirë procesi karstik?

- A) Në klimën e nxehtë të lagësht
- B) Në klimën e ftohtë të lagësht
- C) Në klimën mesdhetare
- D) Në klimën e ftohtë të thatë

Pyetja 262

Nëse konsiderojmë zhvillimin e karstit të ri që nga neogjeni e deri në ditët e sotme, në cilën periudhë karsti është zhvilluar më pak ose ka qenë pothuaj i ndërprerë?

- A) Në periudhën deri në miocenin e sipërm
- B) Në periudhën e fundit të neogjenit
- C) Gjatë periudhës së pleistocenit
- D) Gjatë periudhës së holocenit

Pyetja 263

Cila nga format e mëposhtme karstike nuk bën pjesë në grupin e formave që quhen lapieze?

- A) Brazdat
- B) Hinkat
- C) Ulluqet
- D) Gishtëzimet

Pyetja 264

Origjina e vërtetë e fushave(poljeve) karstike është:

- A) Rezultat i veprimtarisë lumore
- B) Rezultat i veprimtarisë denuduese
- C) Rezultat i proceseve tektoniko-karstike
- D) Rezultat i një seri shëmbjesh të tokës

Pyetja 265

Në cilën nga luginat e mëposhtme ndodhet kanioni i Grunasit?

- A) Në luginën e Kirit
- B) Në luginën e Thethit
- C) në luginën e Vermoshit
- D) Në luginën e Çeremit

Pyetja 266

Në cilët lloj shkëmbinjsh janë më të zhvilluar dhe më të përhapur kanionet?

- A) Në shkëmbinj të magmatikë
- B) Në shkëmbinj të terrigjenë
- C) Në shkëmbinj të metamorfikë

D) Në shkëmbinjtë gëlqerorë

Pyetja 267

Sa milion km² mbulonin akullnajat rreth 18 mijë vjet më parë?

- A) 52 milion km²
- B) 48 milion km²
- C) 42 milion km²
- D) 38 milion km²

Pyetja 268

Sa milion km² mbulojnë akullnajat sot?

- A) 25 milion km²
- B) 19 milion km²
- C) 15 milion km²
- D) 10 milion km²

Pyetja 269

Sa përqind e akullnajave gjenden në lartësitë e mëdha malore të të gjitha gjerësive gjeografike?

- A) 2%
- B) 4%
- C) 6%
- D) 8%

Pyetja 270

Cili nga këto territore ka sipërfaqe më të madhe me akullnaja?

- A) Groenlandë
- B) Himalaje
- C) Alpet e Europës
- D) Malet e Amerikës Veriore

Pyetja 271

Sa është sipërfaqja me akullnaja në kontinentin e Antarktidës?

- A) 6.5 km²
- B) 10.5 km²
- C) 13.5 km²
- D) 15.5 km²

Pyetja 272

Sa është densiteti i borës?

- A) 30-40 kg/m³
- B) 40-50 kg/m³
- C) 50-70 kg/m³
- D) 70-80 kg/m³

Pyetja 273

Sa është densiteti i borës në gjendje firm?

- A) 100 kg/m³
- B) 200 kg/m³
- C) 300 kg/m³
- D) 400 kg/m³

Pyetja 274

Kur kalohet nga firmi në akull sa arrin densiteti i akullit?

- A) 500 kg/m³
- B) 600 kg/m³
- C) 700 kg/m³
- D) 800 kg/m³

Pyetja 275

Densiteti i akullit të mirfilltë që quhet akullnajë është:

- A) 900 kg/m³
- B) 1000 kg/m³
- C) 1100 kg/m³
- D) 1200 kg/m³

Pyetja 277

Çdo akullnajë si një trup gjigand karakterizohet si:

- A) Akull me bazë të ftohtë
- B) Akull me bazë të ngohtë
- C) Akull me bazë të ftohtë në thellësi
- D) Akull me bazë të ftohtë e të ngrohtë

Pyetja 278

Çfarë trajton ligji Glen?

- A) temperaturën e brendshme të akullnajës
- B) temperaturën e shtresave të sipërme të akullnajës
- C) mënyrat e rrëshqitjes së akullnajës
- D) forcën e lëvizjes së akullnajës

Pyetja 279

Si është shpejtësia e lëvizjes së akullnajës në pjesë të ndryshme të saj?

- A) Shpejtësia është më e madhe në shtresën e mesme të akullnajës
- B) Shpejtësia është më e madhe në pjesën fundore të akullnajës
- C) Shpejtësia është më e madhe në pjesët anësore të akullnajës
- D) Shpejtësia është më e madhe në shtresën e sipërme të akullnajës

Pyetja 280

Në cilën stinë është më e madhe shpejtësia e lëvizjes së akullnajës?

- A) Në stinën e verës kur temperatura është e lartë dhe ushqim i pakët
- B) Në stinën e pranverës kur temperatura ulet dhe ushqimi është i pandryshuar
- C) Në stinën e vjeshtës kur temperatura është e pandryshura dhe ushqimi rritet
- D) Në stinën e dimrit kur temperatura ulet dhe ushqimi rritet

Pyetja 281

Në veprimtarinë morfologjike të akullnajës rol më të rëndësishëm luajnë:

- A) Morenat anësore
- B) Morenat ballore
- C) Morenat e brendshme
- D) Morenat e sipërfaqjes

Pyetja 282

Cilat lloje materialesh inerte që transporton akullnaja janë më të përpunuara?

- A) Materialet e sipërfaqes
- B) Materialet fundore
- C) Materialet anësore
- D) materialet ballore

Pyetja 283

Në cilat lloje akullnajash formohen format pozitive të quajtura drumline?

- A) Në akullnajat malore
- B) Në akullnajat luginore
- C) Në akullnajat kontinentale
- D) Në të gjitha llojet

Pyetja 284

Sa është zakonisht gjatësia e një drumlini?

- A) 1-2 km
- B) 2-3 km
- C) 3-4 km
- D) 4-5 km

Pyetja 285

Sa është zakonisht lartësia e një drumlini?

- A) 30-80 m
- B) 20-70 m
- C) 10-60 m
- D) 5-50 m

Pyetja 286

Sa është zakonisht gjerësia e një drumlini?

- A) Rreth 600 m
- B) Rreth 500 m
- C) Rreth 300 m
- D) Rreth 200 m

Pyetja 287

Një formë pozitive lumokullnajore e formuar me depozitime morenike dhe që ka formën e një kurrizi gjarpërues është:

- A) Oze
- B) Esker
- C) Kame
- D) Zandre

Pyetja 288

Sa përqind e zonave shkretinore është e mbuluar me rërë?

- A) 45-50 %
- B) 35-40%
- C) 25-30 %
- D) 15-20 %

Pyetja 289

Cilat nga llojet e materialeve të mëposhtme **nuk** janë pjesë e zonave shkretinore?

- A) Shkëmbinj rrënjësorë
- B) Depozitime lumore
- C) Materiale të kores së tjetërsimit
- D) Depozitime morenike

Pyetja 290

Veprimtarinë gërryese të erës e favorizon:

- A) Përmasa e materialeve copëzore
- B) Kohezioni i materialeve copëzore
- C) Prezenca e sipërfaqjeve të lagështa
- D) Mbulesa e pakët bimore

Pyetja 291

Sa është shpejtësia e erës që shkakton lëvizjen e masës më të madhe të materialeve që transportohen nga era në zonat shkretinore?

- A) 20-28m/sek.
- B) 18-20 m/sek
- C) 12-18 m/sek
- D) 8 -12 m/sek

Pyetja 292

Dukuri tjetër e veprimtarisë së erës është edhe korazoni. Deri në çfarë lartësie mbi sipërfaqjen e tokës ndodh dukuria e korazonit?

- A) 3-4 m
- B) 2-3 m
- C) 1-2 m
- D) 0,5 -1 m

Pyetja 293

Jardanget, si forma të veprimtarisë së erës janë:

- A) Depresione të gjëra e të përzgjatur
- B) Kodrina të gjera e të përzgjatura
- C) Alternim lugjesh e kurrizesh të përzgjatur
- D) Alternim gropash e kodrinash

Pyetja 294

Ç'janë shkretëtirat gurore ose hamadet?

- A) Sipërfaqje të gjera të mbuluara nga materiale të patransportuara
- B) Sipërfaqje të gjera me reliev të diferencuar nga veprimtaria korazive
- C) Sipërfaqje të gjera të përbëra nga pjesë të rezistente të pa gërryera
- D) Depresione të mëdha e të cekët krijuar në shkretirat rërore

Pyetja 295

Në cilët llojë shkëmbinjsh formohen zakonisht kërpudhat shkëmbore?

- A) Në shkëmbinjtë ranorë
- B) Në shkëmbinjtë konglomeratë
- C) Në shkëmbinjtë argjilorë
- D) Në shkëmbinjtë karbonatikë

Pyetja 296

Sa arrin lartësia e dunave shumë të mëdha në hapësirat shkretinore?

- A) 200 m
- B) 300 m
- C) 400 m
- D) 500 m

Pyetja 297

Sa arrin gjatësia e dunave shumë të mëdha në hapësirat shkretinore?

- A) 4 km
- B) 3 km
- C) 2 km
- D) 1 km

Pyetja 298

Sa është këndi i qetësisë natyrale të rërës së thatë?

- A) 15-200
- B) 20-252
- C) 25-300
- D) 30-350

Pyetja 299

Sa është pjerrësia e dunës në anën(shpatin) nga fryn era?

- A) 20-250
- B) 15-200
- C) 10-150
- D) 5-100

Pyetja 300

Ç'janë erget?

- A) Depresione të formuara në shkretëtira
- B) Kodrina të formuara në shkretëtira
- C) Alternim luginash e kodrinash rërore
- D) Masive të mëdha me kompleks dunash rërore

Pyetja 301

Sa është shpejtësia e lëvizjes së dunave në vit?

- A) 10-20 m/vit
- B) 15-25 m/vit
- C) 20-30 m/vit
- D) 25-35 m/vit

Pyetja 302

Sa është sipërfaqja e një ergu shumë të madh?

- A) Rreth 100 mijë km²
- B) Rreth 200mijë km²
- C) Rreth 300 mijë km²
- D) Rreth 350 mijë km²

Pyetja 303

Lësi është një shtresë toke e formuar në disa zona dhe që përbëhet nga grimca shumë të imëta argjili. Sa është madhësia e grimcave që formon shtresat e lësit?

- A) 0.005 m/m deri 0,5 m/m
- B) 0,006 m/m deri 0,6 m/m
- C) 0,007 m/m deri 0.7 m/m
- D) 0,008 m/m deri 0.8 m/m

Pyetja 304

Në cilën nga këto vende është karakteristike lësi?

- A) Ballkan

- B) Spanjë
- C) Kinë
- D) Meksikë

Pyetja 305

Në cilin nga këto vende **nuk** është karakteristikë lësi?

- A) Europa Qëndrore
- B) SHBA
- C) Rusia Jugore
- D) Italia

Pyetja 306

Sa arrin trashësia e shtresave të lësit në vendet karakteristike të përhapjes së tij?

- A) 1-100 m
- B) 100-200 m
- C) 200-300 m
- D) 300-400 m

Pyetja 307

Depozitimet e lësit **nuk** janë formuar:

- A) Në fushat e mëdha në periferi të akullnajave
- B) Në periferi të shkretëtirave të mëdha rërore
- C) Në territorin e luginave të mëdha lumore
- D) Në hapësirat e gjera të pyjeve ekuatorialë

Pyetja 308

Sa është lartësia që mund të arrijnë valët e shkaktuara nga era?

- A) 10 m
- B) 15 m
- C) 20 m
- D) 25 m

Pyetja 309

Pas distancave të mëdha, lartësia e valëve ulet në krahasim me fillimin. Në sa metra zbret lartësia e një vale 10m të lartë pas 200 km rrugë?

- A) Në 8 m
- B) Në 6 m
- C) Në 4 m
- D) Në 2 m

Pyetja 310

Sa përqind të energjisë humbet një valë pas 200 km rrugë?

- A) 80-90 %
- B) 70-80 %

- C) 60-70 %
- D) 50-60 %

Pyetja 311

Cila nga dukuritë e mëposhtme është gabim. Me zvogëlimin e thellësisë së detit drejt bregut atëherë:

- A) Gjatësia e valës zvogëlohet
- B) Shpejtësia e valës zvogëlohet
- C) Lartësia e valës rritet
- D) Pjerrësia e valës zvogëlohet

Pyetja 312

Në brigjet e cilit kontinent ka 1 baticë dhe 1 zbaticë në 24 orë?

- A) Në brigjet e Azisë
- B) Në brigjet e Amerikës së jugut
- C) Në brigjet e Antarktidës
- D) Në brigjet e Australisë

Pyetja 313

Sa është lartësia e baticave të mëdha?

- A) Mb 4 m
- B) Mbi 6 m
- C) Mbi 8 m
- D) Mbi 10 m

Pyetja 314

Sa arrin lartësia maksimale e baticës në Gjirin Fandi të Kanadasë?

- A) 10 m
- B) 16 m
- C) 18 m
- D) 20 m

Pyetja 315

Falezat si forma të abrazionit detar janë:

- A) Pjesë shpatorë relativisht të pjerrëta që vijnë nën ujë
- B) Pjesë shpatore shumë të pjerrëta që ngrihen mbi nivelin e ujit
- C) Pjesë shpatore pak të pjerrta që vijnë mbi nivelin e ujit
- D) Tarraca me sipërfaqje relativisht të sheshtë në bregdet

Pyetja 316

Nuk janë forma të abrazionit detar:

- A) Falezat
- B) Platformat e abrazionit

- C) Fiordet
- D) Mbetjet dëshmitare

Pyetja 317

Nuk janë forma të depozitimit detar:

- A) Plazhet
- B) Kordonet litoral
- C) Tombolet
- D) Tarracat bregdetare

Pyetja 318

Në tipin e bregdetit depozitues nuk gjenden:

- A) Ledhet
- B) Kordonet
- C) Ishuj
- D) Falezat

Pyetja 319

Bregdeti i tipit rias është krijuar nga:

- A) Zhvillimi i estuareve
- B) Zhvillimi i deltave
- C) Zënia prej detit e grykave lumore
- D) Zënia prej detit e Luginave akullnajore

Pyetja 320

Tombolet janë:

- A) Pengesa ishulore që ndodhen pranë bregut
- B) Breza kordonesh që vendosen paralel me bregdetin
- C) Një ose më shumë kordone që lidhin ishuj me tokën
- D) Një bregdet me estuare e delta

Pyetja 321

Ç'janë polderet?

- A) Pjesë e thatë e një estuari
- B) Pjesë me ujëra e toka e një delte
- C) Ish kënetë bregdetare e bonifikuar
- D) Kordone litorale shumë të gjera

Pyetja 322

Delta më e madhe në bregdetin shqiptar është:

- A) Delta e Bunës
- B) Delta e Matit
- C) Delta e Semanit
- D) Delta e Shkumbinit

Pyetja 323

Sa metra është trashësia e depozitimeve deltaike në deltën e Misisipit?

- A) 100 m
- B) 300 m
- C) 600 m
- D) 1000 m

Pyetja 324

Gjatë periudhës së kuaternarit akujt kanë zbritur përgjithësisht deri në lartësinë:

- A) 500 -600 m
- B) 600-700 m
- C) 700-800 m
- D) 800-1000 m

Kapitulli II. Gjeografia Rajonale

Pyetja 1

Gjeografia Rajonale bën ekspertizën e:

- A) modeleve të funksionimit ambjental të një hapsire
- B) modeleve të funksionimit human të një hapsire
- C) modeleve të funksionimit ambjentalo-human të një hapsire
- D) asnjëra

Pyetja 2

Cila nga zonat e mëposhtme **nuk** bën pjesë në rajonet më të dendura të popullsisë në botë:

- A) Kina Lindore
- B) Nënkontinenti Indian
- C) Argjentina
- D) Europa

Pyetja 3

Cili është tipari demografik që karakterizon popullsinë e vendeve të urbanizuara e industrializuara(SHBA, Europë Perëndimore, Japoni etj.):

- A) Nivel i lartë lindjesh e vdekjesh
- B) Nivel i ulët i vdekjeve
- C) Nivel i ulët i lindjeve
- D) Nivel i ulët i lindjeve e vdekjeve

Pyetja 4

Konsiderohen si zona të lagështa të kontinenteve kryesisht:

- A) Pjesët perëndimore
- B) Pjesët lindore
- C) Pjesët qendrore
- D) Pjesët veriore

Pyetja 5

Si vitet e arta të bujqësisë amerikane njihen:

- A) Vitet 1910-1914
- B) Vitet'20
- C) Vitet'30
- D) Asnjëra

Pyetja 6

Një nga vatrat e hershme të kulturave(civilizimeve) të botës, e njohur si Harku Pjellor, është:

- A) Greqia
- B) Japonia
- C) Lindja e Mesme
- D) Afrika e Zezë

Pyetja 7

Civilizimi actekas u përhap në:

- A) Amerikën Qendrore e Jugore
- B) Meksikën Qendrore e Jugore
- C) Amerikën Qendrore
- D) Meksikën Qendrore

Pyetja 8

Organizimet më të hershme të shtetit perfaqsohen nga:

- A) Fiset
- B) Qytetet
- C) Qytet-shtetet
- D) Tributë

Pyetja 9

Në ekonomitë moderne, punësimi në aktivitet parësor kap:

- A) 10% të forcave të punës
- B) 20% të forcave të punës
- C) 50% të forcave të punës

D) 80% të forcave të punës

Pyetja 10

Në botën e industrializuar, qendrat urbane paraqiten me forma të ndryshme. Një rajon ekonomik periferik, që ka lidhje funksionale me bërthamën urbane quhet:

- A) Qytet primat
- B) Qendër industriale
- C) Hinterland
- D) Qendër mbështetëse

Pyetja 11

Përfaqesuese tipike e vendeve pak të zhvilluara, me rritje minimale të GNP-se është:

- A) Etiopia
- B) India
- C) Tajlanda
- D) Bolivia

Pyetja 12

Vende të tilla si, Bangladeshi, Pakistani, Filipinet, Meksika kanë arritur sukses si rezultat i:

- A) Revolucionit Industrial
- B) Revolucionit Kulturor
- C) Revolucionit të Gjelbër
- D) Asnjëra

Pyetja 13

Cili nga këto shtete bën përjashtim nga përkufizimi "tigrat ekonomike":

- A) Hong-Kongu
- B) Tajvani
- C) Malajzia
- D) India

Pyetja 14

Përgjithësisht, dega kryesore e ekonomisë në vendet më pak të zhvilluara është:

- A) Industria
- B) Bujqësia
- C) Tregtia
- D) Peshkimi

Pyetja 15

Kush mund të quhet zonë qendër e zhvillimit ekonomik:

- A) Europa Perëndimore
- B) Amerika Veriore
- C) Japonia
- D) Të gjitha

Pyetja 16

Sa është numri i hapsirave gjeografike botrore që mund të evidentojmë sot?

- A) 10
- B) 12
- C) 14
- D) 15

Pyetja 17

Diferencimi regjional, fillimisht ka një bazë natyrore. Kështu, Uralet, Malet e Skandinavisë, Masivi Qëndror Francez, Apalashet etj., bëjnë pjesë ne rajonin morfologjik të quajtur:

- A) zonat platformike
- B) zonat e rrudhosjes Alpine
- C) zonat e rrudhosjeve kaledoniane e herceniane
- D) zona të pellgjeve sedimentare

Pyetja 18

Në brezin e nxehtë, sidomos atë të klimës tropikale, zonat më të përshtatshme për t'u populluar e për aktivitetet njerzore janë:

- A) regjionet e larta
- B) zonat e ulëta
- C) zonat pyjore
- D) asnjëra

Pyetja 19

Nxitur edhe nga kushte ekologjike, rajonet më të populluara të rruzullit toksor shtrihen në:

- A) brezin e nxehtë
- B) brezin e ftohtë
- C) brezin mesatar
- D) asnjëra

Pyetja 20

Cili nga shpjegimet e mëposhtme karakterizon inputin:

- A) produkt i gatshëm, i shndërruar që i kalon sferës së konsumit
- B) pasuri natyrore që integrohet ne procesin e prodhimit nga sistemi ekonomik
- C) elemente të prodhimit dhe të konsumit natyror e human

D) asnjëra

Pyetja 21

Hapsira ekonomike botërore dallohet për kontraste të mëdha përsa i përket:

- A) nivelit teknik të prodhimit
- B) nivelit teknilogjik të prodhimit
- C) organizimit të prodhimit
- D) të gjithë këto elemente

Pyetja 22

Rrugët e zhvillimit të kapitalizmit në bujqësi janë:

- A) Rruga prusiane
- B) Rruga amerikane
- C) Si prusiane dhe amerikane
- D) Asnjëra

Pyetja 23

Ku qendron ndryshimi mes dy rrugëve kryesore të zhvillimit të kapitalizmit në bujqësi:

- A) Rruga Amerikane krijoi pronarë tokash
- B) Rruga Prusiane polarizoi shoqërinë në zonat rurale
- C) Rruga Amerikane krijoi ekonomi fermere
- D) Rruga Prusiane krijoi ekonomi të mëdha bujqësore

Pyetja 24

Tre revolucionet e mëdha të shek.VII-të në industri, bujqësi e transport sollën lëvizje migruese të popullsisë. Kjo lëvizje ndikoi në diferencimin rajonal nëpërmjet:

- A) dobësimin të ndjenjës së identitetit regjional
- B) nxitjes së zhvillimit të transportit
- C) rritjes së zhvillimit bujqësor
- D) nxitjes së zhvillimit të mekanizuar

Pyetja 25

Alpidet si struktura gjeologjike lidhen nga pikpamja evolutive dhe moshore me :

- A) Strukturat kaledioniane të Europës
- B) Strukturat herciniane të Europës
- C) Me degën veriore të strukturave alpine
- D) Me degën jugore të strukturave alpine

Pyetja 26

Cilët janë shkëmbinj të më të vjetër që ndërtojnë zonën tektonike të Korabit?

- A) Shkëmbinjtë e ordovik - devonit
- B) Shkëmbinjtë e Triasit
- C) Shkëmbinjtë e Paleogjenit
- D) Shkëmbinjtë e Neogjenit

Pyetja 27

Cilës zonë tektonike i takon njësisë tektonike e Muhur Çajës?

- A) Zonës tektonike të Mirditës
- B) Zonës tektonike të Korabit
- C) Zonës tektonike të Krasta - Cukalit
- D) Zonës tektonike të Krujës

Pyetja 28

Në cilën periudhë gjeologjike filloi formimi i njësive strukturore që quhen "ultësirat ndërmaalore"?

- A) Gjatë periudhës së Kretakut të vonë
- B) Gjatë periudhës së Paleocenit të vonë
- C) Gjatë periudhës së Eocenit të vonë
- D) Gjatë paleogjenit të vonë

Pyetja 29

Çfarë tip strukturash tektonike dominojnë në zonën tektonike Jonike?

- A) Strukturë horst-graben
- B) Strukturë rrudhosje
- C) Strukturë monoklinale
- D) Strukturë e sheshtë

Pyetja 30

Cilët lloje shkëmbinjësh dominojnë në ndërtimin litologjik të zonës tektonike të Sazanit?

- A) Gëlqerorët e kretës
- B) Gëlqerorët e paleocenit
- C) Flishet e oligocenit
- D) Molaset e miocenit

Pyetja 31

Pse gjeosinklinali i albanideve gjatë evolucionit nëndetar është karakterizuar nga alternimi i kurrizeve dhe hullive?

- A) Për shkak të përbërjes litologjike
- B) Për shkak të lëvizjeve sizmike
- C) Për shkak të deformimeve tektonike
- D) Për shkak të shpërthimeve vullkanike

Pyetja 32

Në cilën periudhë kanë ndodhur lëvizjet shkëputëse të tipit horst-graben në Shqipëri?

- A) Gjatë periudhës së Kretës
- B) Gjatë periudhës së Paleogjenit
- C) Gjatë periudhës së Miocenit
- D) Gjatë periudhës së Kuarternarit

Pyetja 33

Çfarë llojë depozitimesh janë depozitimet e kuarternarit?

- A) Depozitime karbonatike
- B) Depozitime magmatike intruzive
- C) Depozitime terrigjene
- D) Depozitime evaporitike

Pyetja 34

Në cilën zonë tektonike kanë përhapje më të madhe shkëmbinjtë magmatikë?

- A) Në zonën e Korabit
- B) Në zonën e Mirditës
- C) Në zonën e Alpeve
- D) Në zonën e Sazanit

Pyetja 35

Cila është periudha gjeologjike në të cilën ka qenë më i zhvilluar magmatizmi?

- A) Periudha paleozoike
- B) Periudha jurasike
- C) Periudha kretake
- D) Periudha paleogjenike

Pyetja 36

Drejtimi kryesor i strukturave të rrudhosura të Albanideve është:

- A) Verilindje - jugperëndim
- B) Lindje - perëndim
- C) Veriperëndim - juglindje
- D) Veri -jug

Pyetja 37

Evolucioni gjeomorfologjik i territorit të Shqipërisë ka filluar në:

- A) Periudhën e Kretës
- B) Periudhën e Paleogjenit
- C) Periudhën e fundit të Jurës
- D) Periudhën e Miocenit

Pyetja 38

Kur një territor karakterizohet nga lëvizje tektonike ngritëse, çfarë procese gjeomorfologjike ndodhin në sipërfaqen e territorit?

- A) Procese që cojnë në peneplenizimin e territorit

- B) Procese të erodimit dhe coptimit të territorit
- C) Procese që ndikojnë në shtimin e depozitimeve në territor
- D) Procese të zvogëlimit të diferencimeve në territor

Pyetja 39

Sa milion vjet më parë rregjistrohet formimi i sipërfaqes së sheshimit të pliocenit të hershëm?

- A) 1 - 2 milion
- B) 3 - 4 milion
- C) 5 - 6 milion
- D) 7 - 8 milion

Pyetja 40

Rrjeti hidrografik i territorit të Shqipërisë është formuar gjatë periudhës së?

- A) Kuarternarit
- B) Pliocenit
- C) Miocenit
- D) Oligocenit

Pyetja 41

Relievi i Ultësirës Perëndimore, i gropave dhe fushëgropave të vendit tonë janë formuar kryesisht gjatë:

- A) Paleocenit
- B) Oligocenit
- C) Miocenit
- D) Kuarternarit

Pyetja 42

Sa përqind e territorit të Shqipërisë ndodhet deri në lartësinë 200 m mbi nivelin e detit?

- A) 22.4%
- B) 23.4%
- C) 24.7%
- D) 25.7%

Pyetja 43

Territoret që kanë vlerën e energjisë së relievit 300 - 500 m/Km² quhen territore me energji:

- A) Të vogël
- B) Mesatare
- C) Të madh
- D) Shumë të madh

Pyetja 44

Përcaktoni malin i cili është zhvilluar në strukturën tektonike të tipit horst.

- A) Mali i Skëndërbeut
- B) Mali i Lungarës

- C) Mali i Cukalit
- D) Mali i Thatë

Pyetja 45

Përcaktoni malin i cili është zhvilluar në strukturën tektonike horstantiklinal.

- A) Mali i Korabit
- B) Mali i Munellës
- C) Mali i Çikës
- D) Mali i Moravës

Pyetja 46

Cila nga njësitë gjeografike të mëposhtme është zhvilluar në strukturë grabenore?

- A) Fusha e Mbishkodrës
- B) Fusha e Myzeqesë
- C) Fusha e Vjosës së Sipërme
- D) Fusha e Kavajës

Pyetja 47

Cila nga njësitë gjeografike të mëposhtme është zhvilluar në strukturë sinklinale.

- A) Vargu malor i Dajtit
- B) Mali i Munellës
- C) Lugina e Përroit të Thatë
- D) Lugina e Fanit të Vogël

Pyetja 48

Përcaktoni nga lista e mëposhtme njësinë gjeografike që është zhvilluar në strukturë antiklinale.

- A) Gryka e Këlcyrës
- B) Lugina e Shushicës
- C) Mali me Gropa
- D) Mali i Dhëmbelit

Pyetja 49

Cili është faktori kryesor modelues i relievit në territorin e Shqipërisë?

- A) Veprimtaria karstike
- B) Proceset erozivo-denuduese
- C) Veprimtaria lumore
- D) Veprimtaria bregdetare

Pyetja 50

Vargu Krujë -Dajt është pjesë e njësisë gjeografike të:

- A) Malësisë së Cërmenikës
- B) Malësisë së Gollabordës
- C) Malësisë së Pukë-Mirditë

D) Malësisë së Martaneshit

Pyetja 51

Shumica e grykëluginave tërthore në vendin tonë janë:

- A) Epigjenetike
- B) Antecedente
- C) Me kalime liqenore
- D) Me zhvillim karstik

Pyetja 53

Cila është veçoria morfologjike determinuese e një lugine akullnajore?

- A) Profili tërthor në formë V-je
- B) Profili tërthor në formë U-je
- C) Profili tërthor në formë govate
- D) Profili tërthor i çrregullt

Pyetja 54

Sa është sipërfaqja e territoreve të degraduara në shkallë të madhe dhe të lartë në vendin tonë?

- A) 16 %
- B) 13 %
- C) 9 %
- D) 6 %

Pyetja 55

Çfarë kushte moti krijon në Shqipëri ndikimi i anticiklonit të Azoreve?

- A) Mot të vranët dhe të lagësht
- B) Mot të ftohtë dhe të thatë
- C) Mot të nxehtë dhe të thatë
- D) Mot të lagësht dhe të ftohtë

Pyetja 56

Rolin kryesor në formimin e kushteve të motit në Shqipëri gjatë gjysmës së ftohtë të vitit e luan:

- A) Cikloni e Gjirit Persik
- B) Cikloni i Islandës
- C) Anticikloni i Mongolisë
- D) Anticikloni i Groenlandës

Pyetja 57

Ku konsiston ndryshimi klimatik më i theksuar midis Fushës së Myzeqesë dhe Fushëgropës së Korcës?

- A) Në vlerat e temperaturës
- B) Në sasinë e reshjeve atmosferike
- C) Në numrin e ditëve të kthjellëta

D) Në numrin e ditëve me vranësira

Pyetja 58

Cili është elementi morfologjik i relievit që ndikon më shumë në formimin e kushteve klimatike të Shqipërisë?

- A) Drejtimi i strukturave të relievit
- B) Shkalla e optimit të relievit
- C) Lartësia mbi nivelin e detit të relievit
- D) Tipi morfografik i relievit

Pyetja 59

Murlani është erë që karakteriohet si:

- A) E ngrohtë dhe e lagësht
- B) E ftohtë dhe e thatë
- C) E ftohtë dhe e lagësht
- D) E ngrohtë dhe e thatë

Pyetja 60

Temperatura mesatare vjetore e territorit të Shqipërisë, e reduktuar në nivel të detit luhetet midis vlerave:

- A) 08 - 13 gradë C
- B) 14 - 18 gradë C
- C) 19 - 23 gradë C
- D) 24 - 29 gradë C

Pyetja 61

Nga ndikimi i cilit faktor kryesisht temperatura mesatare e janarit në Ultësirën e Shkodrës është më e ulët se në Ultësirën e Delvinës?

- A) Malet që ngrihen në lindje të Ultësirës së Shkodrës freskojnë më shumë
- B) Ultësira e Shkodrës ndodhet në gjerësi gjeografike më të mëdha, më larg ekuatorit
- C) Ultësira e Shkodrës ndodhet në lartësi më të mëdha mbi nivelin e detit
- D) Deti Adriatik që ndikon Ultësirën e Shkodrës është më i freskët se sa Deti Jon

Pyetja 62

Në cilat zona të territorit të Shqipërisë amplituda e temperaturës është më e vogël?

- A) Në zonat e ulëta lindore
- B) Në pjesët e larta malore
- C) Në brezin afër bregdetar
- D) Në pjesët e mesme të luginave

Pyetja 63

Sa është përqindja e rrjedhjes ujore që i takon stinës së dimrit në Shqipëri?

- A) 21 - 33%
- B) 33 - 45%

- C) 45 - 57%
- D) 57 - 69%

Pyetja 64

Sa është përbërja e rrjedhjes së ngurtë që kalon nëpërmjet lumenjve e përrenjve në dimër e vjeshtë sëbashku:

- A) 40%
- B) 60%
- C) 70%
- D) 80%

Pyetja 65

Liqene me origjinë karstike në Shqipëri i gjejmë në:

- A) Bllokun e Jezercës
- B) Malet e Lurës
- C) Pllajën e Dumresë
- D) Ultësirën e Shkodrës

Pyetja 66

Faktori kryesor që ka ndikuar në formimin e lagunave bregdetare shqiptare është:

- A) Gërryerja e lumenjve në pjesën e grykëderdhjeve
- B) Meandrimi i lumenjve në pjesën fushore
- C) Veprimtaria akumuluese e dallgëve detare
- D) Veprimtaria gërryese e dallgëve detare

Pyetja 67

Cila nga këto vlera të mëposhtme është volumi uJOR vjetor i lumenjve të Shqipërisë?

- A) 41.2 km³
- B) 46.2 km³
- C) 51.2 km³
- D) 56.2 km³

Pyetja 68

Volumi i përgjithshëm uJOR i Liqenit të Ohrit është:

- A) 20 km³
- B) 30 km³
- C) 40 km³
- D) 50 km³

Pyetja 69

Cilët faktorë kanë ndikuar në formimin e detit Adriatik?

- A) Lëvizjet tektonike rrudhosëse të Paleogjenit
- B) Lëvizjet neotektonike të Pliocen-Kuaternarit
- C) Ngritja e nivelit uJOR të Oqeanit Botëror

D) Lëvizjet tektonike mbihipëse të Kuarternarit

Pyetja 71

Përcaktoni se cila nga të dhënat e mëposhtëme tregon numrin e llojeve të bimësisë së Shqipërisë

- A) 4500
- B) 3400
- C) 3250
- D) 2600

Pyetja 72

Në Shqipëri gjenden dhe rriten:

- A) 18 % të bimëve të Europës
- B) 28 % të bimëve të Europës
- C) 31 % të bimëve të Europës
- D) 41 % të bimëve të Europës

Pyetja 73

Në Shqipëri ekzistojnë dy pamje floristike, ajo mesdhetare dhe ajo meseuropiane, të cilat ndahen relativisht nga një vijë. Ku kalon kjo vijë ndarëse?

- A) Tropojë - Burrel-Tiranë - Vlorë
- B) Shkodër - Tiranë - Elbasan -Korçë
- C) Koplik - Tiranë - Elbasanë - Leskovik
- D) Vlore -Elbasan - Burrel -Bajram Curri

Pyetja 74

Llojet e bimësisë së tipit meseuropian në Shqipëri zenë:

- A) 65 %
- B) 55 %
- C) 45 %
- D) 35 %

Pyetja 75

Në cilën pjesë të territorit të Shqipërisë druri i ahut rritet në lartësi më të ulëta?

- A) në Shqipërinë veriore
- B) Në Shqipërinë qendrore
- C) Në Shqipërinë juglindore
- D) Në Shqipërinë Jugore

Pyetja 76

Çfarë statusi mbrojtës ka pylli i dushkut në Kardhiq të Gjirokastrës, ?

- A) Monument natyre
- B) Park kombëtar
- C) Rezervat shkencor

D) Peizazh i mbrojtur

Pyetja 77

Cili është faktori kryesor diferencues dhe i përcaktimit të njësive e nënnjësive fiziko-geografike për zonat kodrinore-malore?

- A) Ndërtimi gjeologjik
- B) Veçoritë e relievit
- C) Veçoritë klimatike
- D) Veçoritë hidrografike

Pyetja 78

Çfarë lloj shkëmbinjsh dominojnë në krahinën e Alpeve të Shqipërisë?

- A) Dolomitë
- B) Gëlqerorë
- C) Magmatikë
- D) Terrigjenë

Pyetja 79

Sa përqind të territorit të Alpeve zenë lartësitë mbi 1000m?

- A) 45 %
- B) 55 %
- C) 65 %
- D) 75 %

Pyetja 80

Pse në Alpet e Shqipërisë coptimi horizontal i relievit është i vogël(mesatarja 2 km/km²)?

- A) Për shkak të ndërtimit tektonik
- B) Për shkak të dominimit të gëlqerorëve
- C) Për ndikimin e kushteve klimatike
- D) Për shkak të evolucionit gjeomorfologjik

Pyetja 81

Cila është veçoria më karakteristike e klimës së Alpeve të Shqipërisë:

- A) Dimri i ftohtë, vera e freskët
- B) Dimri i ftohtë, vera e nxehtë
- C) Vera e lagësht, dimri relativisht i thatë
- D) Vera e thatë, dimri i lagësht

Pyetja 82

Lugu i Runicës është pjesë përbërëse e:

- A) Luginës së Valbonës
- B) Luginës së Shalës
- C) Luginës së Limit
- D) Luginës së Vermoshit

Pyetja 83

Cilët elementë gjeomorfologjikë veçojnë majat dhe kreshtat e Bllokut të Jezercës?

- A) Lugina lumore
- B) Lugina torrenciale
- C) Lugina karstike
- D) Lugje akullnajorë

Pyetja 84

Midis cilave lugina lumore ndodhet kurrizi Dubinë-Golish-Berizhdol?

- A) Luginës së Cemit të Selcës e të Vuklit
- B) Luginës së Cemit e Përroit të Thatë
- C) Luginës së Përroit të Thatë e Rrjollit
- D) Luginës së Bogës e të Thethit

Pyetja 85

Në çfarë strukture tektonike është formuar Lugina e Përroit të Thatë?

- A) Në strukturë sinklinale
- B) Në strukturë antiklinale
- C) Në strukturë monoklinale
- D) Në strukturë shkëputëse

Pyetja 86

Nga pikpamja floristike, brezi bimor dominues në Alpet e Shqipërisë:

- A) Brezi i shkurreve
- B) Brezi i dushqeve
- C) Brezi i ahut
- D) Brezi i kullotave

Pyetja 87

Temperatura mesatare e korrikut në Vermosh është?

- A) 14 gradë C
- B) 15 gradë C
- C) 16 gradë C
- D) 17 gradë C

Pyetja 88

Sa është moduli mesatar i rrjedhjes në territorin e Alpeve të Shqipërisë?

- A) 39 l/sek/km²
- B) 49 l/sek/km²
- C) 59 l/sek/km²
- D) 69 l/sek/km²

Pyetja 89

Në cilët lloje shkëmbinjsh është zhvilluar Malësia e Gjakovës dhe e Hasit

- A) Gëlqerorë
- B) Magmatikë
- C) Terrigjenë
- D) Gipsorë

Pyetja 90

Pse në Malësinë e Gjakovës dhe të Hasit është zvogëluar mjaft erozioni?

- A) Për shkak të ngritjes së bazës së erozionit
- B) Për shkak të shtimit të mbulesës bimore
- C) Për shkak të zvogëlimit të rrjedhjes sipërfaqësore
- D) Për shkak të masave mbrojtëse të marra nga njerëzit

Pyetja 91

Sa është sipërfaqja e Krahinës Malore Qëndrore.

- A) 12000 km²
- B) 13000 km²
- C) 14000 km²
- D) 15000 km²

Pyetja 92

Në cilët lartësi malore janë më të përhapura kullotat alpine në Krahinën Malore Qëndrore?

- A) 1400 - 1600 m
- B) 1500 - 1700 m
- C) 1600 - 1800 m
- D) 1700 - 2000 m

Pyetja 93

Në sa pjesë kryesore fiziko-geografike ndahet Krahina Malore Qëndrore?

- A) 2 pjesë
- B) 3 pjesë
- C) 4 pjesë
- D) 5 pjesë

Pyetja 94

Në cilën pjesë të Krahinës Malore Qendrore bën pjesë Mali i Skënderbeut?

- A) Në Malet e Lurës
- B) Në Lugun e Matit
- C) Në Malësinë Pukë-Mirditë
- D) Në vargjet Perëndimore

Pyetja 95

Gryka e Vanave veçon:

- A) Malin e Koritnikut dhe të Pashtrikut
- B) Malin e Koritnikut dhe të Gjalicës
- C) Malin e Gjalicës dhe të Serakolit
- D) Malin e Bardhe dhe të Deshatit

Pyetja 96

Pjesë e cilës njësi gjeografike është Lugina e Gominës?

- A) Luginës së Drinit
- B) Luginës së Fanit të Madh
- C) Luginës së Fanit të Vogël
- D) Luginës së Matit

Pyetja 97

Ku ndodhen Malet e Lurës?

- A) Midis Luginave të dy Fanëve
- B) Midis Luginës Matit dhe Drinit të Zi
- C) Midis Luginës së Bulqizës dhe Matit
- D) Midis Luginës së Drinit të Zi dhe të Bardhë

Pyetja 98

Sa është lartësia mbi nivelin e detit të Malit të Dejës?

- A) 2140 m
- B) 2240 m
- C) 2246 m
- D) 2340 m

Pyetja 99

Malësia e Martaneshit ndërtohet kryesisht nga shkëmbinjtë:

- A) Gëlqerorë
- B) Terigjenë
- C) Gipsorë
- D) Magmatikë

Pyetja 100

Liqeni akullnajor i quajtur "Liqeni i Zi" ku ndodhet?

- A) Në Malësinë e Çermenikës
- B) Në Malësinë e Martaneshit
- C) Në Malet e Pukës
- D) Në Malin me Gropa

Pyetja 102

Cilat nga territoret malore të mëposhtme **nuk** janë pjesë e harkut malor alpin:

- A) Pirenejtë, ndërmjet Spanjës e Francës

- B) Karpatet, në Europën Lindore
- C) Territoret malore të Bretanjës Franceze
- D) Vargjet Dinarike të bregut dalmat

Pyetja 103

Territoret e Europës Veriore shtrihen deri në lartësitë:

- A) 50 m mbi nivelin e detit
- B) 100 m mbi nivelin e detit
- C) 150 m mbi nivelin e detit
- D) 200 m mbi nivelin e detit

Pyetja 104

Për territore toke të përfituara nga largimi i detit dallohet zona e:

- A) Danimarkës
- B) Hollandës
- C) Gjermanisë Veriore
- D) Suedisë Jugore

Pyetja 105

Europa vlerësohet mes hapësirave më të urbanizuara të botës. Sa % e popullsisë së saj jeton në zona urbane (të vogla apo të mëdha)?

- A) 63%
- B) 73%
- C) 83%
- D) 93%

Pyetja 106

Pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, sa shtete të pavarura u krijuan:

- A) 10 shtete
- B) 12 shtete
- C) 15 shtete
- D) 17 shtete

Pyetja 108

Cili nga territoret e mëposhtme nuk bën pjesë në Mbretërinë e Bashkuar:

- A) Irlanda
- B) Irlanda e Veriut
- C) Skocia
- D) Uells

Pyetja 109

Cili nga qendrat e mëposhtme të Anglisë veriore përfaqson një qytet të vjetër port:

- A) Manchester
- B) Sheffield
- C) Birmingham
- D) Liverpool

Pyetja 110

Kryeqyteti i Irlandës së Veriut është:

- A) Belfasti
- B) Bristol
- C) Dublini
- D) Lidsi

Pyetja 111

Një element pengues për bujqësinë në Irlandë përbën:

- A) Topografia e relievit
- B) Lagështira e tepërt
- C) Terreni malor
- D) Asnjëra

Pyetja 112

Nga pikpamja territoriale, shteti më i madh i Europës Perëndimore është:

- A) Franca
- B) Gjermania
- C) Italia
- D) Britania e Madhe

Pyetja 113

Nga pikpamja demografike e ekonomike, epërsinë në Europën Perëndimore e mban:

- A) Franca
- B) Gjermania
- C) Austria
- D) Zvicra

Pyetja 114

Kompleksi më i madh e më i rëndësishëm i industrisë së rëndë në Europë është:

- A) Saksonia
- B) Silezia

- C) Ruhri
- D) Lorena

Pyetja 116

Sa lande përfshin ndarja administrative e Gjermanisë:

- A) 12
- B) 14
- C) 16
- D) 18

Pyetja 117

Në cilin nga landet gjermane të mëposhtme ndodhet Boni, qendra e ish-Gjermanisë

Perëndimore:

- A) Baden-Vuttemberg
- B) Ren-Vestfalia
- C) Bavaria
- D) Hese

Pyetja 118

Cili nga landet gjermane është i specializuar për përpunimin e qymyrit e prodhimin e celikut:

- A) Saara
- B) Saksoni-Anhalt
- C) Turingia
- D) Holshtein

Pyetja 120

Franca dallohet për potenciale të larta agrikulturore si rezultat i:

- A) Sipërfaqes së madhe të tokës së punueshme
- B) Lagështirës jo ekstreme
- C) Klimës së butë që s'kap ekstreme
- D) Të gjitha

Pyetja 121

Peisazhi kodrinor-pllajor me lartësi mbi 300m mbi nivelin e detit, i quajtur Ardene gjendet në:

- A) Hollandë
- B) Luksenburg
- C) Belgjikë
- D) Francë

Pyetja 122

Vendet e Beneluksit dallohen për:

- A) Dendësi të madhe të popullsisë
- B) Dendësi të vogël të popullsisë
- C) Vitalitet të popullsisë
- D) Asnjëra

Pyetja 123

Porti më i madh i Europës ndodhet në:

- A) Amsterdam
- B) Rotterdam
- C) Liezh
- D) Bruksel

Pyetja 124

Burimi bazë jetësor për Hollandën ka qenë gjithnjë:

- A) Transporti
- B) Tregtia
- C) Agrikultura
- D) Minierat

Pyetja 125

Ndarja etnike Flamandë-Valoni haset në:

- A) Luksenburg
- B) Belgjikë
- C) Hollandë
- D) Danimarkë

Pyetja 126

Aksi Sharlërua-Liezh në Belgjikë dallohet për zhvillim të:

- A) Industrisë së rëndë
- B) Industrisë së lehtë
- C) Industrisë kimike
- D) Prodhimit të mobiljeve

Pyetja 127

Zvicra dhe Austria janë pjesë e rajonit të:

- A) Europës Perëndimore
- B) Europës Veriore

- C) Europes Lindore/Qëndrore
- D) Europës Mesdhetare

Pyetja 128

Sa është numri i gjuhëve që fliten në Zvicër?

- A) 1 gjuhë
- B) 2 gjuhë
- C) 3 gjuhë
- D) 4 gjuhë

Pyetja 129

Cili nga qytetet e mëposhtme është kryeqytti i Zvicrës?

- A) Gjeneva
- B) Zyrihu
- C) Berna
- D) Asnjëra

Pyetja 130

Pas sa kohësh neutraliteti strikt, Zvicra ka zbutur traditën duke u antarsuar në KE e OKB?

- A) 100 vjet
- B) 300 vjet
- C) 5 shekuj
- D) 7 shekuj

Pyetja 131

Vjena, kryeqyteti austriak banohet nga:

- A) 1 milionë banorë
- B) 2.2 milionë banorë
- C) 3 milionë banorë
- D) 4.2 milionë banorë

Pyetja 132

Kur flasim për toka të varfra, zona me pjerrësi të madhe, klimë të ftohtë e burime të rralla minerare, për cilin rajon europian bëhet fjalë:

- A) Europa Lindore
- B) Ishujt Britanikë
- C) Europa Veriore
- D) Europa Jugore

Pyetja 133

Cili nga vendet Nordike po përfiton nga burimet e naftës e gazit natyror të gjetura pranë bregdetit të tij:

- A) Suedia
- B) Norvegjia
- C) Finlanda
- D) Danimarka

Pyetja 134

Cilit shtet i përkasin qytetet Oslo e Bergen?

- A) Suedi
- B) Finlandë
- C) Norvegji
- D) Danimarkë

Pyetja 135

Cilit shtet i përkasin qytetet Malmoe e Goteborg?

- A) Suedi
- B) Finlandë
- C) Norvegji
- D) Danimarkë

Pyetja 136

Për nxjerrjen e cilit mineral dallohet territori i Kirunas në Suedi:

- A) Hekur
- B) Baker
- C) Zink
- D) Magnez

Pyetja 137

Cili nga shtetet nordike dallohet për eksport të prodhimeve të drurit e letrës:

- A) Danimarka
- B) Finlanda
- C) Islanda
- D) Suedia

Pyetja 138

Cili nga kryeqytetet e mëposhtme ka numrin më të madh të popullsisë:

- A) Helsinki
- B) Stokholm
- C) Kopenhagen

D) Oslo

Pyetja 139

Cila nga republikat e ish-BS bën pjesë sot në rajonin e Europës Nordike?

- A) Lituani
- B) Letoni
- C) Estoni
- D) Asnjëra

Pyetja 140

Danimarka dallohet për eksportin e:

- A) Produkteve bujqësore
- B) Produkteve blegtorale
- C) Metaleve të rënda
- D) Prodhimeve tekstile

Pyetja 141

Cili nga këto vende përfaqëson një zonë shkëmbinjsh aktivë vullkanikë:

- A) Danimarka
- B) Islanda
- C) Suedia
- D) Norvegjia

Pyetja 142

Rejkjavik është kryeqyteti i :

- A) Estonisë
- B) Norvegjisë
- C) Islandës
- D) Asnjërës

Pyetja 143

Në rajonin e Europës Jugore bëjnë pjesë:

- A) 3 shtete
- B) 4 shtete
- C) 5 shtete
- D) 6 shtete

Pyetja 144

Rrafshnalta e Mesetës gjendet në:

- A) Spanjë
- B) Greqi
- C) Itali
- D) Portugali

Pyetja 145

Ishulli më i madh i Greqisë është:

- A) Rodi
- B) Kreta
- C) Korfuzi
- D) Asnjëri

Pyetja 146

Ku shtrihet Andaluzia në territorin spanjoll?

- A) Në veri
- B) Në lindje
- C) Në jug
- D) Në perëndim

Pyetja 147

- B) temperatura e ujit mbi 18°C dhe e ajrit mbi 20 °C
- C) temperatura e ujit mbi 20°C dhe e ajrit mbi 18 °C
- D) temperatura e ujit mbi 22°C dhe e ajrit mbi 20 °C

Pyetja 97

Në sa forma paraqitet turizmi sportiv, i mirfilltë ose jo?

- A) 15 forma
- B) 25 forma
- C) 35 forma
- D) 45 forma

Pyetja 98

Cili nga nënlojet **nuk** bën pjesë në turizmin kulturor:

- A) turizmi i artit
- B) turizmi i spektakleve

- C) turizmi i konferencave
- D) turizmi arkeologjik

Pyetja 100

Cilat nga karakteristikat e mëposhtme i përkasin turizmit fetar:

- A) rritja e tolerancës fetare
- B) modestia e kërkesave në destinacion
- C) forcimi i marrëdhënieve të vizitorëve me vendasit
- D) kërkesa luksoze në destinacion

Pyetja 101

Sa është intervali i kohëqëndrimit turistik në një destinacion të përkohshëm:

- A) 1 orë deri në 1 muaj
- B) 24 orë deri në 1 vit
- C) 1 ditë deri në 1 muaj
- D) 1 muaj deri në 1 vit

Pyetja 102

Cilat janë ndikimet ekonomike të turizmit në vendet turistike?

- A) Në potencialet e mëdha natyrore për zhvillimin e turizmit.
- B) Në potencialet e mëdha humane për zhvillimin e turizmit
- C) Në shtimin e vendeve të punës në sektorin terciar.
- D) Në shtimin e peizazheve natyrore.

Pyetja 103

Kur një vend quhet që ka bilanc turistik pozitiv?

- A) Kur të ardhurat e grumbulluara nga turistët e ardhur në vend janë më të larta se ato të shpenzuara nga banorët e tyre për turizëm jashtë vendit.
- B) Kur të ardhurat e grumbulluara nga turistët e ardhur në vend janë më të ulëta se ato që shpenzojnë banorët e tyre për turizëm jashtë vendit.
- C) Kur të ardhurat e grumbulluara nga turistët e ardhur në vend janë të njëjta me ato që shpenzojnë banorët e tyre për turizëm jashtë vendit.
- D) Kur të ardhurat e grumbulluara nga turistët e ardhur në vend dhe ato të banorëve të tyre për turizëm jashtë vendit janë më të larta se çdo sektor tjetër ekonomik.

Pyetja 104

Cili nga vendet e renditura më poshtë ka bilanc turistik negativ:

- A) Austria
- B) Franca
- C) Gjermania

D) Spanja

Pyetja 105

Cila nga kategoritë e zonave të mbrojtura paraqitet si më "liberale" në depërtimin e shfrytëzimit turistik:

- A) rezervatet natyrore shkencore
- B) parqet kombëtare
- C) rezervatet natyrore të menaxhuara
- D) peisazhet natyrore të mbrojtura

Pyetja 106

Hapësira e "turizmit të bazuar në natyrë"(natyror), përmbledh:

- A) një bërthamë aktiviteteve në hotele luksoze pranë natyrës
- B) vizitimi i elementëve specifik të natyrës apo ambiente natyrore të padëmtuara
- C) vizitimi i plazheve për banja dielli
- D) vizitimi i restoranteve luksozë në zona natyrore

Pyetja 107

Cilat konsiderohen raporte të drejta të ngarkesës turistike për ekoturizmin (turistë/banorë):

- A) 2/1
- B) 3/1
- C) 4/1
- D) 5/1

Pyetja 108

Kundrejt ambientit natyror apo dhe kulturor, ekoturizmi dallon për efektin e tij:

- A) rivlerësues
- B) rigjenerues
- C) mirëmbajtës
- D) të trefishtë

Pyetja 109

Me termin anekumena kuptojmë:

- A) Hapësirën në të cilën njeriu nuk është në gjendje të përshtatet për të siguruar jetesën e tij.
- B) Hapësirën në të cilën njeriu është i aftë të përshtatet e të bëjë të mundur ekzistencën e vet.
- C) Hapësirën transitore nga një zonë e banuar nga njerëzit në një tjetër që nuk jep mundësi jetese.
- D) Hapësirën ku njeriu ushtron vetëm aktivitet social.

Kapitulli IV. Historia Botërore

Pyetja 1

E vërteta historike është:

- A) absolute matematikore
- B) objektive dhe subjektive
- C) e paarritshme
- D) abstrakte

Pyetja 2

Koha e shpejtë lidhet me:

- A) ndryshimet konjunkturale
- B) kohën e ardhshme
- C) kohën kur ndodh ngjarja (kur shkruhet historia)
- D) me epikën e klanit

Pyetja 3

Diplomatika merret me:

- A) mbetjet materiale të së kaluarës
- B) përshkrimin e monedhave
- C) shkencën e librave
- D) shqyrtimin e dative, origjinës dhe autenticitetit

Pyetja 4

Të parët që u përpoqën të kishin kujdes për datat ishin:

- A) kinezët
- B) romakët
- C) grekët
- D) hebrenjtë

Pyetja 5

Kalendari i ri doli në shekullin:

- A) XII
- B) XV
- C) XIV
- D) XVI

Pyetja 6

Si "babai i historisë" konsiderohet:

- A) Tukiditi
- B) Herodoti
- C) Sima Cian
- D) Ciceroni
- E) Apiani

Pyetja 7

Epoka më e hershme dhe më e gjatë e shoqërisë njerëzore është:

- A) Epoka e Paleolitit
- B) Epoka e Mezolitit
- C) Epoka e Neolitit
- D) Epoka e Eneolitit

Pyetja 8

Procesi i Antropogjenezës (procesi i gjatë dhe i ndërlikuar i formimit të shoqërisë njerëzore) përfundon në:

- A) Paleolitit e ulët
- B) Paleolitit e mesëm
- C) Neolitit e hershëm
- D) Paleolitit e lartë

Pyetja 9

Fillimet e artit primitiv i kemi që në fundin e epokës së:

- A) Paleolitit të ulët
- B) Paleolitit të mesëm
- C) Paleolitit të lartë
- D) Mezolitit

Pyetja 10

Njeriu i Neandertalit datohet në:

- A) Paleolitit e ulët
- B) Paleolitit e mesëm
- C) Paleolitit e Lartë
- D) Neolitit e hershëm

Pyetja 11

Njeriu i Kromanjonit (Cro - Magnon) datohet në:

- A) Paleolitit e ulët
- B) Paleolitit e mesëm
- C) Paleolitit e Lartë
- D) Neolitit e hershëm

Pyetja 12

Zbulimi i mënyrës së ndezjes artificiale (me fërkim) të zjarrit datohet në:

- A) Paleolitit e ulët
- B) Paleolitit e mesëm
- C) Paleolitit e Lartë
- D) Neolitit e hershëm

Pyetja 13

Gjurmët më të hershme të ritit të varrimit në shoqërinë njerëzore datohen në:

- A) Paleolitin e ulët
- B) Paleolitin e mesëm
- C) Paleolitin e Lartë
- D) Neolitin e hershëm

Pyetja 14

Veglat mikrolitike, të bëra nga ashkla stralli me forma të rregullta gjeometrike janë karakteristike për epokën e:

- A) Paleolinit
- B) Mezolinit
- C) Neolinit
- D) Eneolinit

Pyetja 15

Ndryshimet më të rëndësishme të marrëdhënieve të njeriut me natyrën në epokën e gurit shënohen në:

- A) Paleolit
- B) Mezolit
- C) Neolit
- D) Eneolit

Pyetja 16

Teknologjia e lëmimit dhe e brimimit të veglave prej guri datohet në epokën e:

- A) Paleolinit
- B) Mezolinit
- C) Neolinit
- D) Eneolinit

Pyetja 17

Bujqësia dhe blegtoria në epokën e gurit shënojnë një zhvillim më të avancuar në:

- A) Paleolitin e mesëm
- B) Paleolitin e lartë
- C) Epokën e Mezolinit
- D) Epokën e Neolinit

Pyetja 18

Prodhimi i enëve prej balte (qeramikës) u zbulua për here të pare në epokën e:

- A) Mezolinit
- B) Neolinit
- C) Bronxit
- D) Hekurit

Pyetja 19

Tjerrja edhe endja janë risi për epokën e:

- A) Mezolitit
- B) Neolitit
- C) Bronxit
- D) Hekurit

Pyetja 20

Epoka kur njeriu filloi të përdorë metalin e parë quhet:

- A) Mezolit
- B) Neolit
- C) Eneolit
- D) Bronx

Pyetja 21

Etapën e fundit të epokës së gurit e përfaqëson:

- A) Epoka e Paleolitit
- B) Epoka e Mezolitit
- C) Epoka e Neolitit
- D) Epoka e Eneolitit

Pyetja 22

Lulëzimin më të madh kulturor e epokës së bronxit e arriti:

- A) në vendet e Evropës Qendrore
- B) në vendet e Evropës Perëndimore
- C) në vendet e Egjeut
- D) në vendet e Afrikës Veriore

Pyetja 23

Një nga zbulimet më të rëndësishme që bëri me të vërtetë revolucion në përgatitjen e veglave të punës, dhe si pasojë në prodhim, ishte njohja dhe përdorimi i:

- A) bakrit
- B) hekurit
- C) kallajit
- D) bronxit

Pyetja 24

Cilin nga tiparet e mëposhtme duhet të përmbajë një shoqëri e civilizuar?

- A) mure rrethuese të fortifikuara
- B) rrugë të gjera
- C) strukturën klasore
- D) ndërtimin e banesave

Pyetja 25

Dega kryesore e ekonomisë në qytetërimet e para lumore ishte:

- A) tregtia
- B) artizanati
- C) blegtoria
- D) bujqësia

Pyetja 26

"Rrjeti (sistemi) i irigacionit" në lashtësi ishte karakteristike për qytetërimin:

- A) fenikas
- B) egjiptian
- C) Persian
- D) kinez

Pyetja 27

Perëndesha egjiptiane që përfaqësohej si gjysëm burrë dhe gjysëm grua ishte ajo e:

- A) qiellit
- B) tokës
- C) diellit
- D) ujit

Pyetja 28

Amoni u bë kryeperëndi e shtetit egjiptian në kohën e:

- A) mbretërisë së hershme
- B) mbretërisë së mesme
- C) mbretërisë së re
- D) mbretërisë së vonë

Pyetja 29

Shkrimi me hieroglifë **nuk** përdorej prej:

- A) aristokracisë
- B) fesë
- C) shtetit
- D) popullit të thjeshtë

Pyetja 30

Dëshifrimi i shkrimit hieroglifik u realizua nga:

- A) A. Evans
- B) H. Shliman
- C) M. Ventris
- D) Zh. F. Shampoljon

Pyetja 31

Egjiptologjia **nuk** studion dëshifrimin e shkrimit:

- A) hieroglifik
- B) hieratic
- C) demotik
- D) kuneiform

Pyetja 32

Zanafillën e ndarjes së ditëve të javës në ditë të mira dhe në ditë të këqija e hasim tek:

- A) egjiptianët
- B) shumerët
- C) akadasit
- D) asirianët

Pyetja 33

Ndër popujt e lashtësisë që bënë epokë në fushën e mjekësisë ishin:

- A) shumerët
- B) akadasit
- C) babilonasit
- D) egjiptianët

Pyetja 34

Cilit vend të Lindjes së Lashtë i përkasin dy nga shtatë mrekullitë e botës antike:

- A) Asirisë
- B) Indisë
- C) Kinës
- D) Egjiptit

Pyetja 35

Faraoni Hufu, quhej Keops nga:

- A) persianët
- B) fenikasit
- C) grekët
- D) kinezët

Pyetja 36

Cila nga piramidat e Egjiptit të lashtë konsiderohet si një nga shtatë mrekullitë e botës antike:

- A) piramida e Zoserit
- B) piramida e Hefrenit
- C) piramida e Gizesë
- D) piramida e Keopsit

Pyetja 37

Traktati ndërkombëtar më i vjetër në botë është ai i nënshkruar midis:

- A) Ramsesit II dhe Hatushilit
- B) Ramsesit II dhe Darit I

- C) Ramsesit II dhe Hiramit
- D) Ramsesit II dhe Setit II

Pyetja 38

Formimi i Perandorisë Egjiptiane ndodhi në periudhën e:

- A) mbretërisë së hershme
- B) mbretërisë së mesme
- C) mbretërisë së re
- D) mbretërisë së vonë

Pyetja 39

Krijuesit e shkrimit kuneiform ishin:

- A) elamitët
- B) shumerët
- C) babilonasit
- D) asirianët

Pyetja 40

Si vepra letrare më e hershme e njerëzimit konsiderohet:

- A) Iliada
- B) Odisea
- C) Eposi i Gilgameshit
- D) Eneida

Pyetja 41

Të parët që i dhanë njerëzimit sistemin pozicional të numrave ishin:

- A) fenikasit
- B) indianët
- C) babilonasit
- D) kinezët

Pyetja 42

Qysh nga lashtësia, si biblioteka e parë e botës konsiderohet ajo e mbretërve të mëposhtëm:

- A) e Ashurbanipalit
- B) e Solomonit
- C) e Roboamit
- D) e Ashokës

Pyetja 43

Javën shtatëditëshe romakët e huazuan nga:

- A) grekët
- B) babilonasit
- C) galët
- D) etruskët

E) kinezët

Pyetja 44

Në cilin prej qytetërimeve të Mesopotamisë së lashtë gjendeshin "kopshtet e varura" të Semiramidës:

- A) në Shumeri
- B) në Akadi
- C) në Babiloni
- D) në Persi

Pyetja 45

Me titullin mbretëror "raxha" quheshin mbretërit e:

- A) Egjiptit
- B) Persisë
- C) Asirisë
- D) Indisë
- E) Kinës

Pyetja 46

Si themelues i ushtrisë profesioniste në historinë e njerëzimit konsiderohet:

- A) Aleksandri i Madh
- B) Nabuhodonosori
- C) Sargoni I
- D) Çandragupta

Pyetja 47

Sistemin më të zhvilluar të infrastruktures rrugore në Antikitet e kishte qytetërimi:

- A) neobabilonas
- B) indian
- C) persian
- D) fenikas

Pyetja 48

Tregtarët më të mëdhenj të botës antike ishin:

- A) persianët
- B) fenikasit
- C) grekët
- D) indianët

Pyetja 49

Shkrimi alfabetik është përdorur për here të parë nga:

- A) hebrejtë
- B) grekët
- C) romakët

- D) fenikasit
- E) egjiptianët

Pyetja 50

E vetmja grua historian në të gjithë botën antike ishte:

- A) shumere
- B) greke
- C) kineze
- D) persiane

Pyetja 51

Krijuesit e sistemit dhjetor të numërimit ishin:

- A) egjiptianët
- B) indianët
- C) babilonasit
- D) fenikasit

Pyetja 52

Qytetërimi Hetit (Hitit) lokalizohej gjeografikisht në territoret e sotme të:

- A) Palestinës
- B) Izraelit
- C) Iranit
- D) Turqisë Lindore
- E) Azerbajxhanit

Pyetja 53

Kryeqendra e qytetërimit Hetit (Hitit) ishte:

- A) Menfi
- B) Teba
- C) Hatusas
- D) Ninive
- E) Persepolis

Pyetja 54

Cili nga popujt e botës antike **nuk** bën pjesë në grupin semit?

- A) etruskët
- B) arabët
- C) asirianët
- D) fenikasit

Pyetja 55

Sanskritishtja ishte gjuha e lashtë e:

- A) hebrejve judeas
- B) hinduve të Indisë

- C) akeasve grekë
- D) amorejve semitikë

Pyetja 56

Kasta më e lartë elitare e shoqërisë indiane në lashtësi ishte ajo e:

- A) brahmanëve
- B) kshatrëve
- C) vajshëve
- D) shundrave

Pyetja 57

Kasta më e ulët e shoqërisë indiane në lashtësi ishte ajo e:

- A) brahmanëve
- B) kshatrëve
- C) vajshëve
- D) shundrave

Pyetja 58

Shteti i njësuar hebre i lashtësisë u krijua nga:

- A) Sauli
- B) Davidi
- C) Solomoni
- D) Roboami

Pyetja 59

Cili mbret ka hyrë në historinë e Izraelit të lashtë si arkitekt i politikës ndërtimore të shtetit:

- A) Omri
- B) Roboami
- C) Solomoni
- D) Davidi

Pyetja 60

Qytetërimi i njësuar kinez i lashtësisë u arrit gjatë dinastisë :

- A) Han
- B) Cin
- C) Shan - INJ
- D) Çzhout Lindor

Pyetja 61

Konfucianizmi u sanksionua me ligj si fe zyrtare e shtetit kinez në lashtësi nga dinastia:

- A) Han
- B) Cin
- C) Shan - INJ
- D) Çzhout Lindor

Pyetja 62

Cili nga sistemet filozofike të Kinës së lashtë pranonte objektivitetin e botës, duke dalë kundër hyjnizimit të Qiellit dhe të vullnetit qiellor?

- A) konfucianizmi
- B) moçizmi
- C) taoizmi
- D) legalizmi

Pyetja 63

Në periudhën e vonë minoike dominonte pallati i:

- A) Knosit
- B) Festit
- C) Malit
- D) Kato-Zarkos

Pyetja 64

Cili nga grupfiset e mëposhtme **nuk** i përket Greqisë së Lashtë?

- A) akeasit
- B) elamitët
- C) eolët
- D) dorët
- E) jonët

Pyetja 65

Qytetërimi i Kretës - Minoike u shkatërrua në mesin e shekullit e:

- A) XV p.e.s.
- B) XVI p.e.s.
- C) XVIII p.e.s.
- D) XVIII p.e.s.

Pyetja 66

Përmendorja më e hershme e qytetërimit mikenas janë:

- A) tempujt
- B) varrezat minierë
- C) teatrot
- D) cirkuset

Pyetja 67

Qytetërimin e dytë pallator në Evropën antike e përfaqëson:

- A) Athina
- B) Sparta
- C) Mikena
- D) Kreta

Pyetja 68

Cili nga pallatet mbretërore **nuk** i përket qytetërimit mikenas?

- A) Tirinthi
- B) Pilosi
- C) Teba
- D) Mikena
- E) Festi

Pyetja 69

Në periudhën homerike të Greqisë së lashtë, "thetët" ishin të ngjashëm me:

- A) kalorësit
- B) argatët
- C) skllëvërit
- D) aristokratët

Pyetja 70

Në jetën shoqërore të polisit homerik konsiderohej si i "huaj":

- A) metanasti
- B) theti
- C) meteku
- D) ilioti

Pyetja 71

Grekët e periudhës homerike nuk merreshin fare me:

- A) zejtari
- B) bujqësi
- C) blegtori
- D) tregti

Pyetja 72

Në Greqinë e lashtë, etapa polisore nuk përfshin periudhën:

- A) mikenase
- B) homerike
- C) arkaike
- D) klasike
- E) helenistike

Pyetja 73

Në cilën periudhë, qytetërimi helen në Greqinë evropiane arriti kulmin e tij?

- A) homerike
- B) arkaike
- C) klasike
- D) helenistike

Pyetja 74

Bazën e këmbësisë ushtarake në Greqinë e lashtë e përbënin:

- A) hoplitët
- B) iliotët
- C) periekët
- D) metekët

Pyetja 75

Si formë e organizimit politik, ekonomik dhe social, polisi në Greqinë antike përfaqësonte një:

- A) monarki
- B) republikë
- C) qytet - shtet
- D) tirani
- E) diktaturë

Pyetja 76

Kolonizimi i madh grek në Antikitët u realizua midis shekujve:

- A) VIII - VI p.e.s.
- B) VIII - V p.e.s.
- C) V - IV p.e.s.
- D) VI - II p.e.s.

Pyetja 77

Kolonia e parë greke në Evropën Perëndimore ishte:

- A) Tarenti
- B) Masalia
- C) Kuma
- D) Neapoli

Pyetja 78

Kolonia më e madhe greke në Evropën Perëndimore ishte:

- A) Masalia
- B) Sibarisi
- C) Tarenti
- D) Neapoli
- E) Sirakuza

Pyetja 79

Rajoni i pagëzuar me emrin "Magna Grecia" (Greqia e Madhe) ishte:

- A) Spanja Jugore
- B) Afrika Veriore
- C) Italia Jugore
- D) Franca Jugore

Pyetja 80

Sipas emërtimeve zyrtare, shteti Spartan në Antikitete quhej:

- A) Arkadi
- B) Laqedemoni
- C) Lakoni
- D) Meseni

Pyetja 81

Cila nga këto kategori sociale gëzonte më pak të drejta në Greqinë antike?

- A) metekët
- B) periekët
- C) iliotët
- D) metanastët

Pyetja 82

Të ashtuquajturat "sisiti" ose "fididi" në Greqinë e lashtë u krijuan nga:

- A) Soloni
- B) Pisistrati
- C) Perikliu
- D) Klistheni
- E) Likurgu

Pyetja 83

Fuqizimi ushtarak dhe rritja progresive e autoritetit ndërkombëtar i hapën rrugën Spartës për të vendosur hegjemoninë e saj në:

- A) Thesali
- B) Fokidë
- C) Peloponez
- D) Atikë

Pyetja 84

Në cilin qytet - shtet të Greqisë antike qeverisnin njëkohësisht dy mbretëri:

- A) Spartës
- B) Athinës
- C) Megarës
- D) Korinthit

Pyetja 85

Këshilli i Pleqve ose Herusia ishte karakteristik për qytet - shtetin e:

- A) Spartës
- B) Athinës
- C) Megarës
- D) Korinthit

Pyetja 86

Apela në Spartë ishte një institucion që përfaqësonte:

- A) gjykatën e lartë
- B) sistemin fiscal
- C) komandën ushtarake
- D) kuvendin e popullit

Pyetja 87

Në Athinën e vjetër "demiurgët" përbënin shtresën e:

- A) fshatarëve
- B) zejtarëve
- C) aristokratëve
- D) skllevërve

Pyetja 88

Në Athinën e vjetër "geomorët" përbënin shtresën e:

- A) tregtarëve
- B) zejtarëve
- C) aristokratëve
- D) bujqëve
- E) skllevërve

Pyetja 89

Në Athinën e vjetër "eupatridët" përbënin shtresën e:

- A) tregtarëve
- B) zejtarëve
- C) aristokratëve
- D) bujqëve
- E) skllevërve

Pyetja 90

Cili grupim social në Athinën e vjetër nuk zotëronte asnjë lloj pasurie?

- A) demiurgët
- B) eupatridët
- C) tetët
- D) geomorët

Pyetja 91

"Sinoikizmin" në Athinë e vendosi:

- A) Soloni
- B) Perikliu
- C) Tezeu
- D) Klistheni

Pyetja 92

Në Athinën e vjetër, komandant i ushtrisë ishte arkondi:

- A) eponim
- B) bazile
- C) polemarch
- D) deniurg

Pyetja 93

Aeropagu ishte organi më i lartë i shtetit në:

- A) Spartë
- B) Athinë
- C) Korinth
- D) Mikenë

Pyetja 94

Helieja, organi më i lartë gjyqësor në Athinën e vjetër u krijua në kohën e:

- A) Perikliut
- B) Klisthenit
- C) Drakonit
- D) Solonit
- E) Pistratit

Pyetja 95

Në polisët antike greke, Buleja ishte:

- A) zona tregtare
- B) këshilli i qytetit
- C) zona fetare
- D) zona mbrojtëse

Pyetja 96

Ndarja e popullsisë mbi bazën e censit të pasurisë në Athinën e vjetër u bë nga:

- A) Perikliu
- B) Soloni
- C) Pistrati
- D) Klistheni

Pyetja 97

Cili udhëheqës në Athinën e vjetër, për të rimëkëmbur ekonomitë e vogla fshatare, aplikoi kreditë e vogla bujqësore?

- A) Pistrati
- B) Hiparku
- C) Megakli
- D) Soloni

E) Hipsia

Pyetja 98

Në përputhje me interesat ekonomike të popullsisë, ndarjen territorial të Atikës e bëri:

- A) Klistheni
- B) Pisistarti
- C) Megakli
- D) Hiparku

Pyetja 99

Ostrakizmi ose "gryqi i pllakave" u krijua për të prerë rrugën rivendosjes së:

- A) oligarkisë
- B) tiranisë
- C) demokracisë
- D) teokracisë

Pyetja 100

I pari qytet - shtet grek që u ngrit kundër pushtimit Persian ishte:

- A) Athina
- B) Sparta
- C) Eritrea
- D) Mileti
- E) Korinthi

Pyetja 101

Beteja e famshme e Marathonës, e cila ka hyrë në historinë e artit ushtarak antik u zhvillua në vitin:

- A) 500 p.e.s.
- B) 495 p.e.s.
- C) 490 p.e.s.
- D) 480 p.e.s.

Pyetja 102

Në Greqinë e lashtë, ligji ua ndalonte të braktisnin fushën e betejës:

- A) athinasve
- B) spartanëve
- C) thesalëve
- D) korinthisve

Pyetja 103

Në betejën e Termopileve grekët i udhëhiqte:

- A) Miltiadi
- B) Ksanthipi
- C) Leonidha

D) Themistokliu

Pyetja 104

Simahia (Lidhja) ushtarake e Delosit drejtohej nga qytet - shteti i:

- A) Korinthit
- B) Spartës
- C) Miletit
- D) Athinës

Pyetja 105

Në Greqinë e lashtë "hopliti" ishte:

- A) funksionar i administratës civile
- B) funksionar i gjykatës ushtarake
- C) këmbësor i armatosur rëndë
- D) kalorës

Pyetja 106

Në Greqinë e lashtë, nëpunësit filluan të paguheshin nga arka e shtetit në kohën e:

- A) Klisthenit
- B) Solonit
- C) Pisistratit
- D) Perikliut

Pyetja 107

Në kohën e qeverisjes së Perikliut, fondi i posaçëm "teorikon" u krijua për të mbështetur:

- A) pjesmarrjen në shfaqjet teatrale të qytetarëve të varfër
- B) nxitjen e ndërtimeve publike
- C) përmirësimin e armatimit ushtarak
- D) shpërblimin e qytetarëve të shquar për merita të veçanta

Pyetja 108

Periudha e artë e demokracisë athinase në Antikitët u arrit gjatë qeverisjes së:

- A) Solonit
- B) Perikliut
- C) Klisthenit
- D) Pisistratit

Pyetja 109

Shteti i Egjiptit të lashtë ishte:

- A) republikë despotike
- B) monarki despotike
- C) monarki kushtetuese
- D) monarki parlamentare

Pyetja 110

Perandoria e parë e botës e formuar rreth vitit 2335 - 2279 p.e.s.u formua nga:

- A) Sargoni
- B) Dari
- C) Senakeribi
- D) Aleksandri i Madh

Pyetja 111

Kodi i parë i ligjeve të shkruara i përket:

- A) Konfucit
- B) Budës
- C) Hamurabit
- D) Drakonit

Pyetja 112

Periudha e piramidave në Egjipt i përket epokës së:

- A) mbretërisë së vjetër
- B) mbretërisë së mesme
- C) mbretërisë së re
- D) të dy mbretërive

Pyetja 113

Faraoni egjiptian Menesi sundoi në:

- A) mbretërinë e re
- B) mbretërinë e vjetër
- C) mbretërinë e mesme
- D) Egjiptin e sipërm

Pyetja 114

Janë konsideruar korrierë të qytetërimit:

- A) babilonasit
- B) egjiptianët
- C) fenikasit
- D) sumerët

Pyetja 115

Perandoria më e madhe e historisë së lashtë në Lindjen e Afërme ishte:

- A) Perandoria Perse
- B) Perandoria e Asirisë
- C) Mbretëria e Babilonisë
- D) Mbretëria e Egjiptit

Pyetja 116

Forma dominuese e qeverisjes në shtetet greke të qytetërimit helenik ishte:

- A) monarkia
- B) despotia
- C) oligarkia
- D) autokracia

Pyetja 117

Ngulimet helene u quajtën:

- A) koloni
- B) polise
- C) dema
- D) nome

Pyetja 118

Themeluesi i shtetit të Athinës ishte:

- A) Likurgu
- B) Tezeu
- C) Klistheni
- D) Drakoni

Pyetja 119

Ndarja më e vogël territoriale në shtetin e Athinës ishte:

- A) dema
- B) nomi
- C) polisi
- D) neukrari

Pyetja 120

Ligjet më të ashpra të shtetit të Athinës ishin:

- A) ligjet e Drakonit
- B) ligjet e Likurgut
- C) ligjet e Solonit
- D) ligjet e Tezeut

Pyetja 121

E drejta e shkruar në Athinë u krijua për herë të parë me ligjet e:

- A) Solonit
- B) Drakonit
- C) Tezeut
- D) Likurgut

Pyetja 122

Praktika e ostrakizmës ishte në fuqi:

- A) në shtetin e Athinës

- B) në shtetin e Romës
- C) në shtetin e Spartës
- D) në shtetin e Babilonisë

Pyetja 123

Praktika e ostrakizmës në shtetin e Athinës kishte për objekt:

- A) dëbimin nga qyteti për një periudhë kohe të personave të rrezikshëm
- B) ndarjen e re të shoqërisë athinase në bazë të cenzeve
- C) hedhjen e bazave të demokracisë së drejtpërdrejtë
- D) vendosjen e barazisë sociale të qytetarëve të Athinës.

Pyetja 124

Organi më i lartë administrativ në periudhën e demokracisë klasike në Athinë ishte:

- A) Eklesia
- B) Këshilli i 500 - tëve
- C) Bazileusi
- D) Eforati

Pyetja 125

Vendimet e kuvendit popullor në shtetin e Athinës emërtoheshin:

- A) edite
- B) grafe
- C) nomos/psethizma
- D) senatus consulta

Pyetja 126

Cili nga reformatorët në Greqinë e vjetër njohu me ligj të drejtën e trashëgimisë së pasurisë:

- A) Likurgu
- B) Soloni
- C) Perikliu
- D) Efiditi
- E) Klistheni

Pyetja 127

Sklavëria për borxhe në Athinë u hoq përgjithmonë nga:

- A) Soloni
- B) Klistheni
- C) Likurgu
- D) Tezeu

Pyetja 128

Reforma e timokracisë në Athinë ishte vepër e:

- A) Tezeut
- B) Likurgut

- C) Drakonit
- D) Solonit

Pyetja 129

E reja më e rëndësishme që sollën "Ligjet e Drakonit" ishte:

- A) anulimi i skllavërisë për borxhe
- B) njohja e të drejtës së pronësisë private mbi tokën
- C) shpallja e ligjit mbi larine e testamentit
- D) ligji mbi maksimumin e tokës

Pyetja 130

Ostrakizmi ose "gjqyqi i pllakave" në Athinën e vjetër lidhet me emrin e:

- A) Drakonit
- B) Perikliut
- C) Solonit
- D) Klisthenit

Pyetja 131

Kolegjin e dhjetë strategëve në shtetin e Athinës së vjetër e krijoi:

- A) Klistheni
- B) Pisistrati
- C) Soloni
- D) Perikliu

Pyetja 132

Administrata shtetërore në shtetin e Spartës drejtohej nga:

- A) gerontët
- B) eforët
- C) arhondët
- D) demiurgët

Pyetja 133

Institucioni "grafeparanomoni" i krijuar në kohën e Perikliut mbulonte:

- A) të drejtën e qytetarëve për t'u ankuar për shkeljen e ligjeve
- B) të drejtën për të ngritur një padi civile
- C) të drejtën për të nisur një procedim penal
- D) të drejtën për të marrë pjesë në hartimin e ligjit

Pyetja 134

E drejta e qytetarëve të Athinës që të paraqisnin kërkesa ndaj shkeljeve të ligjit quhej:

- A) teorikon
- B) grafeparanomoni
- C) sinoikizëm
- D) ostrakizëm

Pyetja 135

Me reformën e Likurgut në shtetin e Spartës u vendos:

- A) grafeparanomoni
- B) ligji i ostrakizmës
- C) anulimi i huave dhe çlirimi i debitorëve
- D) rindarja e barabartë e tokës

Pyetja 136

Njerëzit pa të drejta në shtetin e Spartës ishin:

- A) klientët
- B) periekët
- C) iliotët
- D) metekët

Pyetja 137

Toka në Spartë ishte e ndarë në ngastra të barabarta që quheshin:

- A) klerë
- B) dhema
- C) neukrari
- D) marka

Pyetja 138

Mbrojtësit e ligjit ekzistues në kuvendin e Athinës ishin:

- A) nomothetët
- B) sindikët
- C) eforët
- D) arhondët

Pyetja 139

Me anën e reformave të Likurgut u vendos:

- A) anulimi i skllavërisë për borxhe
- B) rindarja e barabartë e tokës
- C) vendosja e praktikës së ostrakizmës
- D) vendosja e grafe paranom

Pyetja 140

Ligjet e reja të vendosura nga Perikliu në Athinë:

- A) u dhanë mundësi qytetarëve të zgjidheshin në poste shtetërore
- B) forcuan organizimin ushtarak të shtetit të Athinës
- C) bënë ndarjen e re të barabartë të tokës
- D) u dha mundësi personave të akuzuar të mbroheshin në gjyq

Pyetja 141

Me ligjet e reja të Perikliut:

- A) krijohet praktika e dëbimit të qytetarëve të rrezikshëm nga Athina
- B) çlirohen debitorët nga borxhet
- C) vendoset që nënpunësit të marrin rrogë nga arka e shtetit
- D) forcohet liria e trashëgimisë

Pyetja 142

Këshilli i 500 - tëve në shtetin e Athinës u krijua:

- A) me ligjet e Tezeut
- B) me reformat e Solonit
- C) me ligjet e Likurgut
- D) me ligjet e Klisthenit

Pyetja 143

Njerëzit me të drejta jo të barabarta me qytetarët e Athinës quheshin:

- A) iliotë
- B) plebej
- C) periekë
- D) metekë

Pyetja 144

Ligjvënësi i shtetit të Spartës ishte:

- A) Tezeu
- B) Likurgu
- C) Soloni
- D) Klistheni

Pyetja 145

Lufta e Peloponezit u zhvillua ndërmjet:

- A) Spartës dhe Persisë
- B) Athinës dhe Spartës
- C) Greqisë dhe Romës
- D) Greqisë dhe Trojës

Pyetja 146

Padia "grafeparanomon" për shkeljen e ligjeve mund të ngrihej:

- A) nga çdo qytetar i Athinës
- B) vetëm nga pala e interesuar
- C) vetëm nga prokurori
- D) vetëm nga jerontët

Pyetja 147

Mbreti i shtetit të Maqedonisë së lashtë Filipi II organ kryesor të qeverisjes kishte:

- A) "miqtë e mbretit" ose "hetere"
- B) senatin
- C) heliea
- D) aeropagun

Pyetja 148

Lidhja Panhelenike e qytet - shteteve greke u krijua nga:

- A) Perikliu
- B) Filipi II i Maqedonisë
- C) Aleksandri i Madh
- D) Isokrati

Pyetja 149

Kufijtë lindorë të perandorisë së Aleksandrit të Madh arritën deri në:

- A) Mongoli
- B) Kinë
- C) Japoni
- D) Indi

Pyetja 150

Rexi në Romën e Lashtë zgjidhej nga:

- A) centurionët
- B) concilia plebis
- C) senati
- D) kuvendi i popullit

Pyetja 151

Reforma e Serv Tullit si njësi organizative politiko - ushtarake në Romën e Lashtë krijoi:

- A) centurionet
- B) dhemat
- C) krahinat
- D) konciliat plebis

Pyetja 152

Me reformën e Serv Tullit:

- A) krijohet fondi i të varfërve "teorikon"
- B) u shkatërrua rendi gjinor
- C) popullsia romake u nda në 3 tribu
- D) u lejuan martesat e patricëve me plebejtë

Pyetja 153

Ligji i 12 tabelave është një ligj i cili u miratua:

- A) në shtetin e Athinës
- B) në shtetin e Egjiptit

- C) në shtetin e Babilonisë
- D) në shtetin e Romës

Pyetja 154

Me ligjin e 12 tabelave në Romën e Lashtë:

- A) mbrohet e drejta e pronës private dhe nuk lejohet cënimi i të drejtës shtetërore
- B) senati u bë organi kryesor i republikës Romane
- C) u shkatërrua rendi gjinor
- D) u lejua martesat ndërmjet patricëve dhe plebejve

Pyetja 155

Lex Canula në vitin 445 p.e.s.:

- A) i përfshiu plebejtë në "populus romanus quiritēs"
- B) hoqi pengesat që ndalonin martesat ndërmjet patricëve dhe plebejve
- C) ndau popullsinë romake në pesë kategori sipas rangut të pasurisë
- D) krijoi organin e magistraturës së tribunëve të popullit

Pyetja 156

Vendimet e kuvendeve të plebejve emërtoheshin:

- A) senatus consulta
- B) edikte
- C) ligje
- D) ordianca

Pyetja 157

Senati në periudhën e republikës në Romë:

- A) miratonte ligjet që pranoheshin nga mbledhjet e kuvendeve të popullit
- B) kishte si funksion të zgjidhte Rex - in
- C) pezullonte urdhërat e tribuneve plebejane
- D) anulonte aktet e padrejta të konsujve përmes vendosjes së vetos

Pyetja 158

Magjistratët në Republikën Romane:

- A) zgjidheshin nga kuvendi popullor
- B) caktoheshin nga koncilia plebis
- C) zgjidhen në mbledhjet e centurionëve
- D) caktoheshin nga Rexi

Pyetja 159

Personat zyrtarë që gëzonin pushtet imperium në shtetin e Romës ishin:

- A) arhondët
- B) gerontët
- C) magjistratët
- D) deputetët

Pyetja 160

Pushtet imperium në Romën e Lashtë kishin:

- A) eforët
- B) cenzorët
- C) kuestorët
- D) pretorët

Pyetja 161

Pushtet potestas në Romën e Lashtë gëzonin:

- A) diktatorët
- B) kuestorët
- C) pretorët
- D) arhondët

Pyetja 162

Tiber Graku hartoi një ligj me të cilin:

- A) kufizojë sipërfaqja e tokës së familjeve të pasura deri në 150 ha
- B) lejojë përfshirja e skllëvërve në popullsinë romane
- C) u bë një reformë e fuqishme ushtarake në Romë
- D) bëhej largimi nga Roma i personave të rrezikshëm

Pyetja 163

Me reformën ushtarake të Gai Marit:

- A) kufizohet sipërfaqja e pronësisë së tokave në Romë deri në 150 ha
- B) me 16 vjet në ushtri çdo romak me vendim të senatit merr shpërblim një copë tokë
- C) senati vendosi që ushtarë të merren vetëm fshatarët pronarë të një ngastre
- D) krijohet ushtria e rregullt në Romë

Pyetja 164

Sundimtarët e Triumviratit të Parë në Romë ishin:

- A) Pompei - Cezari - Kasi
- B) Cezari - Mark Antoni - Oktaviani
- C) Graku - Oktaviani - Bruti
- D) Cezari - Bruti - Graku

Pyetja 165

Treshja sunduese e Triumviratit të Dytë ishte:

- A) Cezari - Mark Antoni - Oktaviani
- B) Graku - Oktaviani - Mark Antoni
- C) Gai - Cezari - Bruti
- D) Mark Antoni - Lepidi - Oktaviani

Pyetja 166

Rendi gjinor në Romën e Lashtë u shkatërrua me:

- A) reformat e Serv Tullit
- B) reformat e Tiber Grakut
- C) reformat e Hanibalit
- D) reformat e Oktavianit

Pyetja 167

Oktaviani nxorri ligje që:

- A) forconin familjen dhe dënonin tradhëtinë bashkëshortore
- B) ndalonin plebejtë të marrin pjesë në drejtimin politik
- C) organizonin ushtrinë në legjione prej 6000 vetësh
- D) kufizonin sistemin e fajdesë

Pyetja 168

Këshilli i 20 -tëve që quhej "Miqtë"i krijuar nga Oktaviani kishte funksion:

- A) të zgjidhte nëpunësit e administratës romane
- B) të caktonte komandantët e legjionëve romane
- C) të pezullonte vendimet dhe urdhërat e nëpunësve
- D) të përgatiste paraprakisht ligjet

Pyetja 169

Qytetarët autoktonë të Romës së Lashtë ishin:

- A) klientët
- B) periekët
- C) metekët
- D) patronët

Pyetja 170

Popullsia e ardhur në Romën e Lashtë ishin:

- A) klientët
- B) patricët
- C) patronët
- D) metekët

Pyetja 171

Kuvendi popullor në shtetin e Romës së Lashtë mblidhej në bazë të:

- A) tribuve
- B) kurive
- C) dhemave
- D) filive

Pyetja 172

Vendimet për pranimin e fiseve të reja në Romën e Lashtë i merrte:

- A) senati
- B) rexi
- C) kuvendi
- D) concilias plebis

Pyetja 173

Rexi në Romën e Lashtë zgjidhej nga:

- A) senati
- B) kuvendi
- C) centurionët
- D) concilia plebis

Pyetja 174

Vendimet e kuvendit në Romën e Lashtë miratoheshin nga:

- A) rexi
- B) senati
- C) tribunët
- D) centurionët

Pyetja 175

Njësia politiko - ushtarake e krijuar në Romë me reformën e S.Tulit ishte:

- A) kuria
- B) centurioni
- C) dhema
- D) filea

Pyetja 176

Reforma shoqërore e S.Tulit:

- A) futi plebejtë në përbërjen e popullit romak
- B) lejoj martesat e plebejve me patricët
- C) rindau popullsinë romake në gens
- D) ndau territorin romak në file

Pyetja 177

Tribunët plebejanë në Romën e Lashtë kishin:

- A) pushtet urdhërues
- B) të drejtën e vetos mbi urdhërat e personave zyrtarë
- C) pushtet ligjvënës
- D) pushtet ushtarak

Pyetja 178

Republika e lashtë romake ishte:

- A) demokraci skllavopronare
- B) oligarki skllavopronare

- C) aristokraci skllavopronare
- D) despotizëm skllavopronar

Pyetja 179

Ndihmësi më i afërt i perndorit romak ishte:

- A) cenzori
- B) cezari
- C) rexi
- D) magistrati

Pyetja 180

Organi qëndror në periudhën e dominatit në Romë ishte:

- A) senati
- B) tribunati
- C) këshilli i perandorit
- D) centurioni

Pyetja 181

Në epokën perandorake Romën e dogji:

- A) Kaligula
- B) Tiberi
- C) Neroni
- D) Nerva

Pyetja 182

I pari perandor i Romës me origjinë joromake ishte:

- A) Nerva
- B) Adriani
- C) Trajani
- D) Vespasiani

Pyetja 183

Shtirjen më të gjerë territorial Perandoria Romake e arriti gjatë qeverisjes së dinastisë perandorake të:

- A) Klauðëve
- B) Flavëve
- C) Antoninëve
- D) Severëve

Pyetja 184

"Perandori filozof" në Romë quhej:

- A) Aurel Komodi
- B) Mark Aureli
- C) Antonin Piu

D) Serv Galba

Pyetja 185

Koloseu në Romë u ndërtua në kohën e perandorit romak:

- A) Vespasianit
- B) Titit
- C) Domicianit
- D) Adrianit

Pyetja 186

Edikti i Karakallës ose "Kushtetuta e Antoninianit" e vitit 212 shpallte:

- A) ndarjen e barabartë të tokës në Perandorinë Romake
- B) zyrtarizimin e fesë kristiane
- C) njohjen e lirisë së besimit për të krishterët
- D) dhënien e të drejtës së qytetarisë romake të gjithë banorëve të lire të Perandorisë Romake

Pyetja 187

Në Romën perandorake, "Tetrarkia" ose qeverisja e katër perandorëve u realizua nga:

- A) Oktaviani
- B) Diokleciani
- C) Maksimiani
- D) Kostandini i Madh

Pyetja 188

Edikti i Milanit i vitit 313:

- A) dhuroi lirinë e besimit të krishterëve
- B) krijoj organin e "Këshillit të rincepsit"
- C) bëri reformimin e senatit romak
- D) ndau Perandorinë Romake në dy pjesë

Pyetja 189

Perandoria Romake u nda në dy pjesë në vitin:

- A) 313
- B) 378
- C) 380
- D) 395

Pyetja 190

Perandoria Romake e Perëndimit u shemb përfundimisht në vitin:

- A) 410
- B) 455
- C) 476
- D) 496

Pyetja 191

Perandori i madh indian Asoka:

- A) ndoqi një politikë të egër despotike
- B) bëri thirrje për siguri, vetkontroll, tolerancë, drejtësi dhe lumturi
- C) është krijuesi i perandorisë indiane të Megadhës
- D) është ai që shpërndau përfundimisht perandorinë indiane Gupta

Pyetja 192

Në periudhën e dinastisë kineze Han:

- A) baza e politikës perandorake ishte drejtësia dhe paqja
- B) u mbyllën në Kinë të gjithë manastiret e murgjëve budistë
- C) u vendos sistemi i provimeve me shkrim për zyrtarët
- D) u krye reforma më e madhe agrare në Kinë

Pyetja 193

Në periudhën e dinastisë kineze Han:

- A) ishte kusht që nëpunësit të ishin të arsimuar
- B) përfundoi ndërtimi i Murit të Madh kinez
- C) u ndërmor një fushatë e egër për djegjen e librave
- D) filloj të zbatohet i ashtuquajtur i mendim legalist

Pyetja 194

Për funksionimin e burokracisë shtetërore, zbatimin e sistemit të provimeve konkurruese e kërkoi:

- A) Buda
- B) Konfuci
- C) Asoka
- D) Sargoni

Pyetja 195

Perandoria e parë në Indi u krijua:

- A) pas pushtimeve ariane
- B) pas shembjes së perandorisë së Aleksandrit të Madh
- C) në kohën e sundimit të Asokës
- D) në kohën e Guptës

Pyetja 196

Kodi me rregullat që duhej t'i përmbahej secila kastë dhe pjestarët e saj në Indi njihet me emrin:

- A) raxhai
- B) brahma
- C) dhrama
- D) karma

Pyetja 197

Epoka klasike në Indi, u quajt periudha e sundimit të perandorisë:

- A) Mauruane
- B) Gupta
- C) Mongule
- D) Sulltanatit të Delhit

Pyetja 198

Dinastia Gupta sundoi në:

- A) Kinë
- B) Japoni
- C) Indi
- D) Mongoli

Pyetja 199

Sundimi perandorak në Indi u konsolidua në kohën e:

- A) Gautamës
- B) Asokës
- C) Akbarit
- D) Sargonit

Pyetja 200

Akbari sundoi gjatë perandorisë:

- A) Mauruane
- B) Gupta
- C) Mongule
- D) Sulltanatit të Delhit

Pyetja 201

E veçanta në qytetërimin Indian ishte se:

- A) u bë takimi midis civilizimit hindu dhe atij mysliman
- B) u bë takimi midis civilizimit budist dhe atij mysliman
- C) u bë takimi midis civilizimit konfucian dhe atij mysliman
- D) u bë takimi midis civilizimit taoist dhe atij mysliman

Pyetja 202

Idea sipas së cilës, shteti qëndron mbi çdo gjë, u bë mbizotëruese në Kinë, në kohën e sundimit të dinastisë:

- A) Çing
- B) Han
- C) Cin
- D) Tang

Pyetja 203

Të parët perëndimorë që hynë në Japoni ishin:

- A) portugezët
- B) anglezët
- C) francezët
- D) spanjollët

Pyetja 204

Fillimi i kalendarit islam lidhet me:

- A) lindjen e profetit Muhamed
- B) largimin e tij në Medinë
- C) hyrjen e tij në Mekë
- D) vdekjen e profetit Muhamed

Pyetja 205

Modernizmi në qytetërimet joevropiane përmban:

- A) arritjet e shoqërive perëndimore në zhvillimin shoqëror
- B) arritjet e shoqërive joevropiane në zhvillimin ekonomik
- C) me praktikat institucionale në vendet perëndimore
- D) arritjet e shoqërive evropiane në aspektin intelektual

Pyetja 206

E veçanta e modernizmit të Kinës pas vitit 1978 është:

- A) modernizimi i bujqësisë
- B) modernizimi i industrisë
- C) modernizimi ekonomik para reformimit politik
- D) hapja e Kinës ndaj kapitalit

Pyetja 207

Revolucioni i madh kulturor dhe proletar në Kinë u nxit nga Mao Ce Duni për:

- A) modernizimin ekonomik
- B) përjetësimin e figurës së Mao Ce Dunit
- C) modernizimin social
- D) modernizimin kulturor

Pyetja 208

Tregues kuptimplotë i Usternizmit në Japoni ishte:

- A) fryma kolektive
- B) mirëqënia
- C) politika e jashtme
- D) kushtetuta

Pyetja 209

Kapitalizmi japonez emërtohet si:

- A) kapitalizëm kooperues
- B) kapitalizëm liberal
- C) kapitalizëm social
- D) merkantilizëm

Pyetja 210

Në Indi sinteza indomyslimane konkretizohej kryesisht në:

- A) kulturë
- B) ekonomi
- C) administratë
- D) politikë

Pyetja 211

Ndryshimet e mëdha në praktikat fetare shkuan paralelisht me:

- A) evoluimin e fesë
- B) me ndryshimet e mëdha të qytetërimeve
- C) me lëvizjet e popullsive të hershme
- D) me përpunimin e doktrinave teologjike

Pyetja 212

Shkrimet e shenjta hindu njihen ndryshe me emrin:

- A) veda
- B) brahma
- C) karma
- D) moksha

Pyetja 213

Jezu Krishti mendohet se lindi në:

- A) Jeruzalem
- B) Nazaret
- C) Betlehem
- D) Çezarea

Pyetja 214

Në fëmijërinë e tij Jezusi u rrit sipas mësimeve:

- A) hinduiste
- B) budiste
- C) judaiste
- D) kristiane

Pyetja 215

Doktrina e "Trinisë e Shenjtë" i takon besimit:

- A) islam
- B) judaist

- C) kristian
- D) budist
- E) jainist

Pyetja 216

Perandoria Bizantine arrin kulmin e zhvillimit nën sundimin e:

- A) Maksimilianit
- B) Ulpianit
- C) Kostandin
- D) Justinianit

Pyetja 217

"Të gjelbrit" ishin grupim politik i:

- A) aristokracisë së lartë
- B) zejtarëve dhe qytetarëve
- C) fshatarëve
- D) popullsisë gjysëm të lirë

Pyetja 218

"Të kaltrit" në Perandorinë Bizantine ishin grupi politik i:

- A) popullsisë gjysëm të lirë
- B) aristokracisë së lartë
- C) zejtarëve dhe qytetarëve
- D) fshatarëve

Pyetja 219

Themelimi i shtetit mongol në Mesjetë u realizua:

- A) Batu
- B) Xhengiz Khani
- C) Timurlengu
- D) Ugedeji

Pyetja 220

Shteti mongol i Xhengiz Khanit:

- A) ishte monarki e kufizuar
- B) ishte në formën e oligarkisë aristokratike
- C) ishte në formën e një republike demokratike primitive
- D) kishte formën e një shteti të theksuar ushtarak

Pyetja 221

Mesjeta e hershme (shekujt V - X) njihet ndryshe edhe si periudha e:

- A) humanizmit
- B) rilindjes
- C) lulëzuar

D) errët

Pyetja 222

Rolin vendimtar në drejtimin e shtetit në shtetin e frankëve e kishte:

- A) senati
- B) дума
- C) tribunati
- D) sundimtari

Pyetja 223

Frankët barbarë ishin fise:

- A) avare
- B) hune
- C) gjermanike
- D) gale
- E) kelte

Pyetja 224

Mbreti frank Klodvigu është:

- A) themeluesi i dinastisë franke Merovinge
- B) themeluesi i dinastisë franke Karoline
- C) kundërshtar i egër i krishtërimin
- D) shkatërruesi i perandorisë së frankëve

Pyetja 225

Me politikën e tij Karli i Madh:

- A) copëtoi mbretërinë merovinge
- B) pengoi zhvillimin e qytetërimit frank
- C) punoi për përhapjen e qytetërimit kristian në Evropë
- D) u ngrit kundër ndikimit të papatit

Pyetja 226

Ndarja në tri pjesë e perandorisë së Karlit të Madh u bë nga:

- A) traktati i Berlinit
- B) traktati i Versajës
- C) traktati i Shën Stefanit
- D) traktati i Verdunit

Pyetja 227

Organizimet me karakter politik në qytetet mesjetare ishin:

- A) vëllazëritë
- B) komunat
- C) gildet
- D) korporatat

Pyetja 228

Qytetet mesjetare të drejtat për ligjet, gjyqet dhe taksat i saksionuan me anën e:

- A) kartave
- B) ordinancave
- C) deklaratave
- D) statuteve

Pyetja 229

E drejta feudale kishte karakteristikë kryesore:

- A) universalitetin
- B) kodifikimin
- C) partikularitetin
- D) sistemimin

Pyetja 230

Elementet bazë të shoqërisë mesjetare janë:

- A) feudalizmi dhe sistemi çifligar
- B) format demokratike të qeverisjes
- C) konstitucionalizmi
- D) e drejta e kodifikuar

Pyetja 231

Çifligu në shoqërinë mesjetare ishte:

- A) një ekonomi e lirë tregtare
- B) një ekonomi e përbashkët
- C) një ekonomi e mbyllur vetëprodhuese
- D) një njësi politike autonome

Pyetja 232

Shtresa shoqërore e lidhur në mënyrë të pazgjdhshme me çifligun ishte:

- A) kallfët
- B) bujkrobërit
- C) senjorët
- D) skllevërit
- E) çirakët

Pyetja 233

Perandoria Bizantine u krijua:

- A) me marrëveshje ndërmjet perandorëve romakë dhe prijësve lindorë
- B) nga i ashtuquajtimi "traktati i themelimit"
- C) si vazhdim i Perandorisë Romake në Lindje
- D) nga dyndjet barbare gjermanike

Pyetja 234

Kalifi ishte kryetar i shtetit në shtetin e:

- A) Egjiptit
- B) Bizantit
- C) Babilonisë
- D) Arabisë

Pyetja 235

Uilliam pushtuesi në Angli:

- A) mbajti për vete 1/6 e tokës dhe pjesën tjetër ua ndau feudalëve normanë
- B) ruajti të pandryshuar organizimin ushtarak anglo - sakson
- C) është krijuesi i anglikanizmit
- D) rekrutoi në ushtri vetëm fshatarët zotërues të ngastrave

Pyetja 236

Domesday Book "Libri i Gjyqit të Tmerrshëm" ishte:

- A) përmbledhje e së drejtës së përgjithshme angleze (common Laë)
- B) regjistri i pronave dhe i popullsisë në Angli
- C) përmbledhje e së drejtës së shpallur nga parlamenti anglez
- D) regjistri i organizatave politike kundërshtare të mbretit

Pyetja 237

Magna Charta (Karta e Madhe e Lirive) (1215) në Angli:

- A) sanksionoi liritë kushtetuese
- B) është modeli i parë i një kushtetute
- C) detyronte mbretin të respektonte të drejtat feudale të lordëve, kishës dhe nënshtetasve të tjerë të mbretërisë
- D) zgjidhi përfundimisht konfliktin ndërmjet mbretit dhe parlamentit

Pyetja 238

"Parlamenti Model" i vitit 1295 u krijua në:

- A) Itali
- B) Angli
- C) Gjermani
- D) Spanjë

Pyetja 239

Me Kartën e Madhe të Lirive në Angli:

- A) sanksionohet republika parlamentare
- B) sanksionohen të drejtat e pakufizuara të mbretit
- C) sanksionohet e drejta e kundërshtimit të mbretit
- D) i jepet fund konfliktit ndërmjet mbretit dhe parlamentit

Pyetja 240

Reforma administrative e Filipit II August në Francë në shekullin XIII e ndau mbretërinë në rajone të barabarta të quajtura:

- A) konte
- B) prefektura
- C) baliazhe
- D) dukate
- E) shire

Pyetja 241

Franca feudale e shekullit XIII ishte:

- A) monarki e kufizuar parlamentare
- B) monarki konstitucionale
- C) monarki feudale
- D) oligarki ushtarake

Pyetja 242

Gjermania u shëndrrua në mbretëri të centralizuar feudale nën sundimin e:

- A) Ottos së Madh (I)
- B) Frederikut I "Barbarosa"
- C) Ottos III
- D) Henriku I "Zogjuajtësi"
- E) Konradi i Frankonisë

Pyetja 243

Lufta afro pesë shekullore për bashkimin e mbretërisë spanjolle në Mesjetë është quajtur:

- A) kundërreformacion
- B) reformacion
- C) renesance
- D) rekonquista

Pyetja 244

E ashtuquajtura lufta 100 vjeçare është zhvilluar ndërmjet:

- A) Anglisë dhe Francës
- B) Anglisë dhe Spanjës
- C) Gjermanisë dhe Francës
- D) Francës dhe Spanjës

Pyetja 245

"Lufta për Investiturë" në Mesjetë u zhvillua midis:

- A) Papatit dhe perandorëve gjermanë
- B) Papatit dhe peshkopëve bizantinë të Lindjes
- C) Papatit dhe heretikëve
- D) Papatit dhe qytet - shteteve italiane

Pyetja 246

Në Mesjetë, Inkuizicioni ishte:

- A) gjyq kishtar për dënimin e heretikëve
- B) sistem fiskal për mbledhjen e taksave
- C) gjykatë e lartë mbretërore
- D) kodi kalorësiak për organizimin e ushtrisë mesjetare

Pyetja 247

Në shpejtimin e pushtimeve osmane ndikuan:

- A) epërsitë e fesë myslimane
- B) dobësia dhe mungesa e zhvillimit në shtetet fqinje
- C) epërsia organizative dhe ushtarake e shtetit të ri osman
- D) aleancat e fuqishme ndërmjet shteteve të tjera

Pyetja 248

Legjislacioni i dyfishtë ishte karakteristikë e:

- A) Perandorisë Bizantine
- B) Perandorisë Karolinge
- C) Perandorisë Osmane
- D) Perandorisë Habsburgase

Pyetja 249

Sheriati është baza ligjore që ka vepruar në:

- A) Perandorinë Osmane
- B) Perandorinë Romake
- C) Perandorinë Franke
- D) Perandorinë Perse

Pyetja 250

Baza ligjore kryesore në Perandorinë Osmane ishte:

- A) urdhërat e sulltanit
- B) e drejta zakonore
- C) kanunet
- D) sheriati

Pyetja 251

Organizimi shtetëror tipik tek popujt e Ballkanit në Mesjetë ishte:

- A) principata
- B) perandoria
- C) republika
- D) dinastia

Pyetja 252

Origjina e universiteteve evropiane datohet në epokën:

- A) antike
- B) mesjetare
- C) moderne
- D) bashkëkohore

Pyetja 253

Shteti i pare sllav që u krijua në Evropë ishte:

- A) shteti polak
- B) shteti rus
- C) shteti bullgar
- D) shteti serb

Pyetja 254

Krijimi i Perandorisë mesjetare Serbe u realizua nga:

- A) Stefan Nemani
- B) Stefan Uroshi
- C) Stefan Dushani
